



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 27 QERSHOR DHE 11 KORRIK 2024**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. JUNA I 11. JULA 2024. GODINE**

**QERSHOR/KORRIK - JUN/JUL
2024**

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
5. Votimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë,
6. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,
7. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,
8. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,
9. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-296 për të huajt,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-277 për sport,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-264 për rininë
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-256 për falimentimin,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-267 për letërnjoftimin,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-274 për shërbimet private të sigurisë,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-304 për bankat,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror,
25. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore,

zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti,

26. Themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e përlogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

27. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH,

28. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

29. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,

30. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,

31. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,

32. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,

2. Izjave van dnevnog reda,

3. Parlamentarna pitanja,

4. Glasanje o N/zakona br. 08/L-309 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju, za prvi program “Finansiranje razvojnih politika za fiskalnu efektivnost, konkurentnost i zeleni rast”, između Republike Kosovo koju zastupa Ministarstva finansija, rada i transfera i Međunarodnog udruženja za razvoj,

5. Izglasavanje Statuta Prištinskog univerziteta “Hasan Prishtina” u Prištini,

6. Glasanje o Drugom razmatranju N/zakona br. 08/L-212 o reproduktivnom zdravlju i medicinski potpomognutoj oplodnji,

7. Glasanje u načelu o N/zakona br. 08/L-266 o građanskom statusu,

8. Glasanje u načelu o N/zakona br. 08/L-300 o državnoj maturi,

9. Glasanje u načelu o N/zakona br. 08/L-296 o stranim licima,

10. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-277 o sportu,

11. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-264 o mladima

12. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-265 o registru stvarnih vlasnika,

13. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-256 o stečaju,

14. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-225 o Odbrambenoj Obaveštajnoj Bezbednosnoj Agenciji,

15. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-261 o zaštiti od požara,
16. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-267 o ličnoj karti,
17. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-274 o uslugama privatnog obezbeđenja,
18. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-249 o izmeni i dopuni Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova,
19. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-272 o izmeni i dopuni Zakona br. 06/L010 o beležništvu, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 08/L-149,
20. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-289 o Nezavisnoj komisiji za medije,
21. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-262 o izmenama i dopunama zakona koji sadrže posebne administrativne postupke i njihovo usklađivanje sa Zakonom br. 05/L-031 o opštem upravnom postupku, druga faza,
22. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-294 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L - 198 o javnim sluzbenicima,
23. Prvo razmatranje N/ zakona br. 08/L-304 o bankama,
24. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-305 o pružaoca usluga vazdušne plovidbe,
25. Glasanje za formiranje Parlamentarne anketne komisije o izvršnim odgovornostima Ministarstva pravde u vezi sa sumnjivim požarima u Institutu za sudsku medicinu, nestankom uzoraka u slučaju Astrit Dehari i bilo kakvom radnjom ili nečinjenjem kojim je ovo ministarstvo narušilo nezavisnost i zakonske odgovornosti ovog instituta,
26. Formiranje Parlamentarne anketne komisije za postupak obračuna dugovanja kompanija za ambalažiranje vode, kao i način i osnov otplate duga od strane Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture,
27. Glasanje o Nacrtu rezolucije u vezi sa nalazima Izveštaja Američkog državnog departmana,
28. Razmatranje Nacrta deklaracije o odnosima Republike Kosovo sa Sjedinjenim Američkim Državama,
29. Razmatranje Nacrta rezolucije koja se bavi pitanjem iseljavanja građana iz Republike Kosovo,
30. Izveštavanje Vlade Republike Kosovo o napretku u toku sprovođenja ciljeva održivog razvoja i reflektovanje Transformativne agende Kosova na budžet i vladine politike,
31. Razmatranje Nacionalnog programa o Evropskim integracijama 2024-2028,
32. Osnivanje ad hoc komisije za izbor kandidata za dva (2) člana Odbora Radiotelevizije Kosova, jednog iz albanske i jednog iz reda srpske zajednice.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Enver Hoxhaj.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që ta hap këtë seancë plenare të Kuvendit të Kosovës duke ju dëshiruar të gjithëve mirëseardhje në këtë seancë, edhe kolegëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Por, para se ta miratojmë procesverbalin, dua ta ftoj deputetin Bekë Berisha, kryetar i Komisionit për Siguri, që ta marrë fjalën.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sot e kemi Projektligjin për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, domethënë Projektligji për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka më shumë se një vit që është në procedurë në shqyrtim në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, por qëllimisht shqyrtimi i tij ka kaluar çdo limit kohor dhe kjo është bërë qëllimshëm nga kryesuesi i grupit punues, deputeti Enver Dugolli, të cilit ia kemi dhënë në mirëbesim ta udhëheqë këtë grup.

Po ashtu, nga përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane u është konfirmuar se përmbajtja e projektligjit të miratuar në Qeveri është në dakordim të plotë me ta si ligj fillimisht, ndërsa në anën tjetër, zoti Dugolli në mënyrë klandestine ka kontrabanduar dhe ka propozuar propozim-amendamente, të cilat nuk janë rezultat i grupit punues, por një rezultat i një rrethi të tij të brendshëm aty, edhe atë e dimë. Ky projektligj me këto amendamente nuk duhet të miratohet, sepse do të cenojë sigurinë kombëtare, mes tjerash, do të cenojë bashkëpunimin në këtë fushë edhe me partnerët tanë. Me theks të veçantë amendamenti numër 1, ndryshimi i titullit të projektligjit. Kjo agjenci e ka mandat jo vetëm veprimtarinë e inteligjencës, por edhe të sigurisë në fushën e mbrojtjes. Nëse hiqet termi “dhe sigurisë” do të cenohet dhe do të kufizohet mandati dhe veprimtaria e kësaj agjencie.

Amendamenti numër 10, ku bëhet fjalë për inspektim të kësaj agjencie. Ky amendament bën që të humbë kuptimi i vetë agjencisë, inspektimi në OISM nuk duhet të kryhet nga inspektori i përgjithshëm i FSK-së, por nga inspektori i përgjithshëm i kësaj agjencie. Amendamenti 32, është propozuar të ulet grada e drejtorit të agjencisë nga ajo e gjeneralit në atë të kolonelit, kjo nuk duhet të ndodhë, sepse në njërin anë po avancohet Drejtoria aktuale për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes dhe po bëhet Agjenci për Inteligjencë dhe Siguri të Mbrojtjes, në anën tjetër, po ulet apo po degradohet grada e udhëheqësit të kësaj agjencie nga ajo e gjeneralit në kolonel. Mbase për të emëruar dikë që është i preferuar i pushtetit për të marrë kontroll edhe në këtë agjenci.

Po ashtu, prit veç pak, jo duhet treguar qëllimet tuaja një herë, pastaj votojmë. Po ashtu, edhe agjencitë homologe të vendeve partnere të NATO-s, e tjera, udhëheqësi i kësaj agjencie është në

gradë të gjeneralit, ju po doni ta ulni. Domethënë, që kjo të mos emërohet pastaj, po doni ta eliminoni presidenten prej krejt këtyre kompetencave dhe ta lëshoni në gradë më të ulët, deri te kryeministri, që keni probleme ndër vete aty. Amendamenti 45, te dispozitat kalimtare. Ky amendament është e keqja më e madhe. Këtu është lënë mundësia shumë e madhe që të krijohet boshllëk rreth 12 muajsh pa instrumente të inteligjencës së mbrojtjes, pasi që do të shuhet Drejtoria aktuale për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes, e po ashtu ky amendament është kundërthënës në përmbajtjen e tij.

KRYESUESI: Zoti Berisha, nëse më lejon?

BEKË BERISHA: Vetëm edhe 20 sekonda i kam edhe përfundova. Në atë drejtori do të sistemohen në detyra të tjera, si dhe në rastin e emërimit të drejtorit nuk do të ketë mundësi ai drejtor të marrë në dorëzim objekte, pajisje, arkivin, dokumentet, si dhe burimet të tjera të Drejtorisë aktuale të Inteligjencës dhe Sigurisë. Pasi që nuk do të ketë memorie institucionale, personel në atë moment, as arkiv e as mundësi që vetë t'i pranojë të gjitha këto resurse.

Unë ju ftoj që kjo nuk duhet të bëhet kështu qysh e ka propozuar Enveri dhe ju brenda, sipas Rregullores, domethënë neni 53, 1.1., të tërhiqet një herë, të kthehet në Komisionin për Siguri, e pastaj e shohim. Po ashtu, kisha ftuar që ky të tërhiqet në plotni, domethënë nga sponsorizuesi. Ky ligj, nëse kalon kështu, do t'i bëjë problem shtetit të Kosovës, nuk e di ku i keni qëllimet, ndoshta veç të kapet, po ky është problem edhe më i madh se veç të kapet. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Berisha, të falënderoj shumë! Unë ju dhashë fjalën juve si kryetar i Komisionit që do të thotë ta prezantoni një kërkesë që mbi të gjitha seanca dhe grupet parlamentare të marrin këtë qëndrim për një temë të tillë. Nuk ishte bash e duhur që shkuat në thellësi në përmbajtje dhe në emra e mbiemra, s'ma merr mendja që ishte qëllimi i takimit, por si deputetë është në fund të ditës vendim juaji.

Tash i ftoj grupet parlamentare, të cilat, me sa e di unë, kanë pasur një kërkesë të tillë që të deklarohen për këtë pikë të rendit të ditës, që ta thonë fjalën e tyre. E do fjalën dikush nga Vetëvendosja?

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë kolegët deputetë,

E gjithashtu edhe për ju media prezente në këtë sallë pak më të ngushtë.

Sa i përket mocionit të kryetarit të Komisionit për Siguri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje më duhet të them se nuk qëndrojnë të gjitha ato pretendimet, të cilat zoti Berisha, deputeti, kryetar i komisionit, i përmendi.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka dakordimin që ky projektligj të kthehet në komision, në mënyrë që të ketë harmonizimin edhe dakordimin bashkë me partnerët, të cilët janë pjesë e diskutimit për temën e sigurisë dhe inteligjencës dhe nuk ka pasur të bëjë me dispozita, të cilat ai i përmendi një nga një që janë tërësisht një tematikë tjetër. Prandaj, ne si grup parlamentar deklarohe mi se pajtohe mi që sot ky projektligj të kthehet në komision, jo të tërhiqet nga sponsorizuesi në këtë rast, t'i kthehet Qeverisë së Republikës, por të jetë në komision dhe në kuadër të komisionit pastaj të trajtohet më tutje për ndjeshmërinë dhe rëndësinë që e ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash e ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Qala.

RASHIT QALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë kolegët deputetë,

Përshëndetje për mediat,

Qytetarë të Kosovës,

Në fakt, tema që u diskutua dhe që u iniciua nga kolegu, kryetari i Komisionit për Siguri dhe Mbrojtje, zoti Bekë Berisha, është një temë shumë sensitive, shumë e ndjeshme.

Meqenëse po flasim për një ligj shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me institucionin më të rëndësishëm të vendit dhe që ka të bëjë me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe komponentën e inteligjencës së saj. Mendoj që është mirë që ky projektligj të kthehet në komision, edhe ose mendoj që është shumë më mirë që të tërhiqet nga sponsorizuesi dhe të startojmë prapë për shkak të shumë çështjeve që janë devijuar rrugës nga projektligji fillestar dhe nuk ka nevojë që të jesh bukur shumë njohës i fushës së sigurisë dhe të shohësh tendencat, të cilat janë reflektuar me amendamentet që janë bërë në grupin punues. Qëndrojnë ato që tha zoti Bekë Berisha, për shkak se vërehet shumë lehtë që është një konflikt, të mos them një luftë, por një konflikt në mes të dy institucioneve kryesore të vendit dhe për mua nuk është me rëndësi fare se kush është kryeministër sot e as kush është presidente sot, por për mua është shumë me rëndësi që institucioni i Presidentes si institucion dhe institucioni i Qeverisë së institucion të jenë përgjegjëse për komponentën e inteligjencës në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Dhe, me këto amendamente qartë vërehet që është përjashtuar, është mënjanuar nga përgjegjësia qoftë për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të inteligjencës në kuadër të FSK-së, për shkak të eliminimit të gradës së gjeneralëve dhe në njërin nga amendamentet kryesore që e përcakton mënyrën se si emërohet drejtori i përgjithshëm në projektligjin fillestar ka qenë sipas procedurave të emërimit të gjeneralëve. Ndërsa, kjo tani është hequr, dhe vetë fakti që nuk qëndron më, i largohet kompetenca institucionit të Presidentit të vendit, që për mua është shumë me rëndësi.

Dhe, po ashtu është shumë e ndjeshme, e dëmshme çështja që ky projektligj të fillojë funksionimin apo implementimin 12 muaj pas miratimit. Dhe, është e pakuptimtë që Forca e Sigurisë së Kosovës për 12 muaj të mos ketë shërbimin inteligjent brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, pra të ketë një hapësirë të zbrazët. Pra, nuk ka fazë kalimtare, fazë transitore që pastaj fillojnë edhe proceset e rekrutimit. E, janë shumë gjëra të tjera, të cilat prapë po them kishte me qenë kërkesë e Grupit Parlamentar të PDK-së që të tërhiqet nga sponsorizuesi dhe pastaj të vazhdojmë me procedura, mirëpo më e pakta që mund të bëhet duhet të kthehet prapë në komision dhe të vazhdojmë tutje prapë.

Prapë po them, duhet të dalim nga petku partiak dhe të mendojmë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të mendojmë për funksionimin e dy institucioneve më të larta të vendit, siç është institucioni i Kryeministrit dhe institucioni i Presidentit, pavarësisht se kush është sot apo kush mund të jetë nesër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Qala! Ndërsa, tash e ftoj deputetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Quni, që ta marrë fjalën. Ideja e këtij debati është që ta jepni një qëndrim të juaj sa më preciz dhe të shkurtë për temën në fjalë, mos shkoni në detaje.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin e Qeverisë,

Për ju deputetë,

Media,

Pasi dëgjuam deklarinimin dhe qëndrimin e shefes së Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, unë do ju kursej nga të gjitha ato elaborimet, të cilat i kam përgatitur në lidhje me këtë çështje, por tani më shumë për atë që nuk janë të familjarizuar me këtë temë që nuk i njohin esencën e çështjeve të inteligjencës ushtarake, thjesht për të pas një qasje më konstruktive në lidhje me këtë temë, unë vetëm po i potencoj disa çështje.

Në Ministri të Mbrojtjes funksionojnë për momentin katër drejtori, ato janë: Drejtoria për Politikë të Mbrojtjes, Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Mbështetjes. Të gjitha këto drejtori janë nën vartësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Dhe të gjitha këto drejtori udhëhiqen nga personeli ushtarak dhe civil të rangut të gjeneralit. Tani me Projektligjin për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ideja është që drejtoria të avancojë në agjenci. Do të thotë, del nga organogrami i përgjegjësive të sekretarit dhe kalon në përgjegjësinë e ministrit të Mbrojtjes, kryeministrit dhe presidentit, kjo është ideja. Me këtë avancim me kalimi nga drejtoria në agjenci do të thotë janë politika të veçanta kadrovike, fondeve, autorizimeve, fushë veprimi e tjera.

Do të thotë, rritet roli i Drejtorisë së Inteligjencës tek roli i agjencisë. Tani, nga kolegu ynë Enver Dugolli janë propozuar disa amendamente që janë shumë paradoksale. Një ndër to është që me

rritjen e përgjegjësive të organizatës ulet grada, rangu i atij që do të udhëheqë me agjencinë. Do të thotë, drejtorinë e udhëheq një gjeneral, kurse agjencinë në të ardhmen mundet me udhëheqë një kolonel. Dhe e dyta...

KRYESUESI: Zoti Quni, me gjithë respektin, meqë nuk ka ndonjë matës të saktë të kohës, unë jam i detyruar që vërtet të kërkoj nga secili nga ju që të jeni sa më preciz, ose e bëj në mënyrë arbitrare dhe në bazë të vullnetit personal.

ANTON QUNI: Edhe çështja e dytë është kohëzgjatja. Kohëzgjatja e kalimit të përgjegjësive nga drejtoria tek agjencia. Nga zoti Dugolli është propozuar amendamenti që kjo kohëzgjatje mund të shkojë deri në një vit.

Do të thotë në momentin që miratohet projektligji, drejtoria pushon së punuari dhe për një vit krijohet një vakuum, do të thotë nuk ka veprimtari, nuk ka punë në fushën e inteligjencës ushtarake për një vit, derisa të krijohet agjencia. Ky është një rrezikim i madh i sigurisë nacionale, i sigurisë kombëtare.

Nuk dua t'i shpalos të gjitha supozimet pse po bëhen këto, por pasi që zonja Kusari Lila tregoi pozitivitet në lidhje me këtë çështje, besoj që me rikthimin e kësaj teme tek komisioni do t'i tejkalojmë të gjitha këto mosmarrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash e ftoj përfaqësuesin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Kryesues, ndoshta e kemi zgjatur pak, mirëpo edhe pamja këtu çka po shohim, edhe nervozizmi, edhe interesimi për t'i votuar amendamentet e Enverit na shqetësoi pak dhe po duam të tregojmë shqetësimin tonë.

Pra, tash si grup, që të mos e zgjas më shumë, ne e përkrahim që të hiqet, të vijë në komision, por e ftoj edhe sponsorizuesin që të tërheqë në tërësi këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Nga Grupi Multietnik, e do dikush fjalën?

Nga Lista serbe, të cilët janë të pranishëm në Kuvend të Kosovës, dëshironi ta keni fjalën? Besoj që është një temë që ju intereson dhe do të ishte mirë që të merrni qëndrim për një temë të tillë, meqë pas 6 muajsh jeni në seancë.

E mendova seriozisht, e doni fjalën Lista serbe?

Nëse jo, e hedhim mocionin në votim dhe e ftoj seancën që të marrë qëndrim, me qëllim që të kthehet në komision.

Kush është për?

Nëse keni mundësi që ta mbani orën më gjatë.

A është dikush kundër?

A ka abstenim?

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Ishte votimi me kërkesë edhe të komisionit përkatës, kryetarit të këtij komisioni që Projektligji për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurinë e Mbrojtjes të kthehet për një raport plotësues për t'u trajtuar në komision, për këtë votuan 69 deputetë për, 4 ishin kundër, asnjë abstenim, kështu që mund të konstatoj që plotësohen kushtet e votimit.

Ky projektligj i kthehet edhe një herë komisionit.

Urdhëroni, Driton Selmanaj e ka kërkuar fjalën për një kërkesë shtesë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht po them që në memoaret e historisë së parlamentarizmit tonë do të mbahet mend që dy herë kjo sallë është shfrytëzuar për të mbajtur seancën plenare. Rasti i parë është për gazin lotsjellës dhe rasti i dytë është për t'ia vazhduar Listës serbe mandatet, sepse rrezikonin që të humbnin mandatet.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetar, meqenëse jemi te pikat e rendit të ditës dhe e përshëndesim vendimin e Kuvendit që vërtet ligji paraprak të kthehet në komision, ne kemi propozim që tri ligjet e tjera, projektligje të tjera t'i kthehen ose komisioneve, ose propozuesit, pse? Dhe cilat janë ato? E para është Ligji për Këshillin Prokurorial, e dyta është Ligji për KPM-në dhe e treta është Ligji për zyrtarët publik. Për të tri këto projektligje, zoti kryetar, Zyra e BE-së në Kosovë dhe Këshilli i Evropës kanë reaguar që materia në të cilën kanë punuar komisionet parlamentare janë kundër standardeve ndërkombëtare.

Ne për dy ligjet e para, Ligjin për KPK-në dhe Ligjin për KPM-në kemi pasur vendime të Gjykatës Kushtetuese që ato janë kundërkushtetuese. Kemi menduar edhe pas vërejtjeve të Komisionit të Venecias që ka pasur një keqlexim dhe nuk është kuptuar drejt Komisioni i Venecias dhe është bërë gabim nga komisioni parlamentar. Por, me ripërtëritjen dhe me punën e serishme që është bërë, e kemi parë që nuk është gabim, nuk është keqlexim, por është punë e

qëllimshme për kapjen e tre segmenteve më të rëndësishme të shoqërisë, që janë: organi i akuzës, mediat dhe administrata e shtetit.

Prandaj ne kërkojmë që këto tria të hiqen, Ligji për KPK-në të kthehet për rimendim Komisionit të Venecias, se kështu ka kërkuar edhe vetë BE-ja, thotë ktheheni edhe një herë, sepse amendamentet nuk i kanë adresuar opinionet e Venecias, në mënyrë që ne të kemi projektligje që vërtetë i plotësojnë standardet, tek e fundit e kemi obligim kushtetues që ligjet tona të jenë në përputhje me 'acquis communautaire'. Nëse ka rrugë tjetër, keni orientime të tjera për një integrim diku tjetër, atëherë unë them që është rrezik për vendin kjo qasje.

Në emër të LDK-së edhe një herë propozoj që të tri këto projektligje të hiqen nga rendi i ditës dhe të kthehen ose te sponsorizuesi ose te komisionet, dhe ndërkohë të shkojnë edhe në Komisionin e Venecias për rikonfirmim të amendamenteve që janë punuar. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo nuk mund të bëhet për grup ligjesh, kështu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, procedurat e kërkojnë, zoti Selmanaj, që për secilin ligj të kërkohet veç e veç, edhe saktësisht çka kërkoni, nëse ka mundësi. Pra, vetëm për njërin e specifikuat çka, për Komisionin e Venedikut që t'i kthehet, për të tjerët na tregoni ose për raport plotësues ose që të hiqet fare nga rendi i ditës për secilin veç e veç. Pastaj vetëm për njërin e hedhim në votim. Urdhëro!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë për Ligjin për KPK-në e kam letrën e BE-së këtu përpara që u ka shkuar edhe kryetarit të Komisionit për ligje dhe kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, ku shpreh shqetësimin dhe kërkon për Ligjin për KPK-në që të rikthehet në Komisionin e Venecias për të konfirmuar nëse opinionet e tyre janë marrë parasysh apo jo.

Ne mund të shkojmë veç e veç, kërkesa jonë e parë është për Ligjin e KPK-së t'i rikthehet Komisionit të Venecias, por edhe Ligi për zyrtarët publikë. Ata thonë që është kundër frymës, ose kundër standardeve që BE i promovon dhe Ligjin për KPM-në. Këto dyja nëse eventualisht nuk ka vullnet që të shkojnë në Komisionin e Venecias, le të kthehen në komision për t'u punuar, ndërkohë për Ligjin për KPK-në ne jemi në linjë me BE-në që kjo të shkojë edhe një herë në Komisionin e Venecias për konfirmim të opinioneve nëse ato janë reflektuar apo jo në punën që është bërë nga ana e komisionit, nga grupi punues. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, i përmbahemi thjesht rendit, së pari është KPK-ja, Ligji për KPK-në. Grupet parlamentare, a dëshirojnë të deklarojnë? Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, Adnan Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nënkryetar,

Ministra,

Kolegë deputetë,

E para, më duket me gjasë që ndryshimi i mjedisit e ka ndryshuar pak edhe praktikën le të themi të paraqitjes së çështjeve dhe të shfrytëzimit të Rregullores. Po flitet për mocion, le të themi për rendin e ditës, qoftë për plotësim, qoftë për tërheqje të pikave të rendit të ditës, ndërkohë që gjithë debati po eskalon në përmbajtje.

Në lidhje me propozimin e zotit Selmanaj, për Projektligjin për KPK-në, pa asnjë problem këtë propozim, paçka se nuk pajtohem, mund ta bënte kur vijmë te pika e rendit të ditës, domethënë sepse ishte propozimi për ta dërguar në Venecia raportin me amendamente. Por, sido që të jetë, më lejoni të them qëndrimin e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Ne nuk pajtohem me propozimin që të tërhiqet si pikë e rendit të ditës, sikurse nuk pajtohem dhe po jap argumente shkurtimisht që duhet të dërgohet ose të ridërgohet në Komisionin e Venecias.

E para, si Kuvend i Kosovës natyrisht që kemi dërguar projektligjin në Komisionin e Venecias dhe kemi marrë të gjitha rekomandimet dhe vlerësimet, si Komision për Legjislacion dhe grupi punues ka trajtuar secilin rekomandim me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë, shoqërisë civile, partnerëve ndërkombëtarë dhe natyrisht që kanë pasur mundësinë edhe deputetët e opozitës për të kontribuar. Zotit Selmanaj shprehimisht e në veçanti në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion ka refuzuar të përfshihet në grupin punues për të trajtuar këtë projektligj me argumentin se ky është kundër që në idenë le të themi ose në koncept me këtë projektligj. E ka pasur mundësinë zoti Selmanaj të japë propozimet, madje dhe kritikën nëse jo propozimet në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion, në grupin punues, për këto gjëra, ne jemi të bindur që keni adresuar secilin rekomandim dhe jemi të bindur që ky raport me amendamente duhet të trajtohet dhe duhet të kalojë në lexim të dytë dhe të hyjë në fuqi sa më parë.

Unë e kuptoj, sikurse edhe në rastet e tjera, që opozita do të përpiqet natyrisht të vonojë, të pamundësojë e të pengojë zbatimin e këtij ligji, por që në fund të fundit është e pashmangshme se ligji do të hyjë në fuqi dhe reforma do të jetësohet. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse ka nevojë, grupet e tjera parlamentare, apo e hedhim në votim? Hajdar Beqa në emër të PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Edhe pse ndoshta në një sallë jo me një atmosferë të punës, por sa i përket pikës që propozoi Driton Selmanaj, një çështje të tillë për Ligjin për Këshill Prokurorial si Parti Demokratike e kemi ngritur edhe në Komision për Legjislacion dhe konsiderojmë që ky ligj, ashtu si i tillë, siç

është sot në rend të ditës, prapë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk duhet të shkojmë më tutje, sepse vetëm humbim kohën.

E kemi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, andaj ne si Parti Demokratike e përkrahim propozimin, është propozim edhe i Partisë Demokratike që ky ligj të kthehet te sponsorizuesi, të punohet me të vërtetë në ligj dhe të shikohet çka duam të arrijmë me këtë ligj. Ne e kemi parë që ky ligj nga fillimi i mandatit të kësaj qeverie e deri tani që jemi në përfundim të mandatit u luajt njëfarë ping-pongu me Ligjin e Këshillit Prokurorial, edhe nëse bëhemi të sinqertë, qëllimi nuk është për ndonjë reformë në Prokurori, as në organin e akuzës, por është qëllimi i numrave herë të rriten numrat e Këshillit Prokuroria, herë të zvogëlohen numrat me të vetmin qëllim që të arrihet të zgjidhet një kryeprokuror, të cilin mendon mazhoranca për ta zgjedhur, e fatkeqësisht Republika e Kosovës nuk ka kryeprokuror që katër vjet, ka ushtrues detyre.

Andaj, ne kërkojmë edhe një herë të bëheni të sinqertë, ta ktheni Ligjin te sponsorizuesi dhe të mos e ketë ky ligj fatin që e pati edhe në fillim që e ktheu Gjykata Kushtetuese dhe prapë nuk është në harmonizim me Gjykatën Kushtetuese, mos e humbni kohën më as të deputetëve, por as prokurorisë. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim në votim, se kjo nuk do shumë diskutime. Pra, e hedhim në votim.

(Ndërprerje e incizimit)

80 deputetë jemi tash të pranishëm. Kështu që, të nderuar, po ua kujtoj edhe një herë për çka po votojmë, eventualisht. Po votojmë për Ligjin për KPK-në. Ishte kërkesë e zotit Selmanaj që ky projektligj të mos trajtohet, po t'i kthehet Komisionit të Venedikut për trajtim edhe një herë, meqenëse institucionet kryesore evropiane e kanë kundërshtuar dhe kanë dhënë vërejtjet dhe kritikën e tyre. Kjo ishte arsyeja.

80 deputetë, a po? Votojmë!

Kush është për propozimin e zotit Selmanaj? Kush është për, po pyes.

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, të nderuar kolegë, rezultati është ky: 27 vota për i mori ky propozim, 47 ishin kundër dhe 4 vota ishin abstenuese. Nuk kalon propozimi i zotit Selmanaj.

Zoti Selmanaj, propozimin e dytë, të lutem!

(Ndërprerje e incizimit)

Zoti Selmanaj, propozimin tjetër nëse ka mundësi, ishte për Këshillin Prokurorial, a po?

DRITON SELMANAJ: Kryetar,

Propozimi ynë është me të njëjtat arsye, se nuk është në përputhje me standardet e BE-së, që edhe i njëjti projektligj të kthehet në komision. Unë veç jam i detyruar t’jua lexoj veç një paragraf çfarë ka thënë BE-ja, zoti kryetar.

Paragrafi thotë kështu: “Ju rekomandojmë fuqishëm ta rikonsultoni, ta rikonsultoni, Komisionin e Venecias. Nëse komentet e Komisionit të Venecias janë marrë parasysh nga komisioni, apo jo. Sepse...”, thotë, “... ne kemi dilemat tona që kjo nuk është bërë”.

Ju po votoni kundër standardeve të BE-së. Unë jam duke folur për Zyrën e BE-së në Kosovë dhe jam duke folur për deklaratën publike të ambasadorit gjerman. Dikush këtu po gënjen, o Adnan Rustemi ose Zyra e BE-së. Zyra e BE-së thotë nuk e keni reflektuar Komisionin e Venecias. Dikush nuk po e thotë të vërtetën. Të them të drejtën, kam prirje t’u besoj miqve, jo Adnan Rustemit. Kam bindje, bre, vëlla.

Prandaj, me kaq masivitet ju ta votoni një projektligj, madje as për konsultë s’po pranoni ta dëgjoni Komisionin e Venecias, vërtet keni zgjedhur një rrugë qorre për vendin, jo për juve, sepse rrugën qorre e keni zgjedhur moti ju. Prandaj, edhe propozimi edhe për këtë projektligj, edhe për projektligjin tjetër, po nëse ka nevojë dal përsëri, janë që t’u kthehen komisioneve, së paku, që komisionet t’i trajtojnë ato dhe të punojnë ngushtë me miqtë tanë, në mënyrë që Raporti i Progresit të jetë ndryshe.

Po jua them edhe një citat tjetër. Zyra e BE-së e thotë: “Nëse këto nuk reflektohen, do t’i shihni në Raport të Progresit”. Dhe, ju po e dini që Raporti i Progresit do të jetë negativ për vendin dhe po i votoni kështu, atëherë ju po u thoni “mirë se vini” edhe raporteve negative për vendin. Nuk e di kujt po i shërbeni! Faleminderit!

KRYETARI: Pra, kjo ishte për KPM-në. Mirë, për KPM-në, Këshillin e Pavarur të Mediave.

Valon Ramadani, në emër të Vetëvendosjes.

VALON RAMADANI: Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Media,

Unë nuk e kisha të qartë se për çfarë çështje specifike foli deputeti Selmanaj, po megjithatë unë po e sqaroj rrjedhën e Komisionit për Administratë Publike, ose në këtë rast për Media, i cili ka bërë punë të jashtëzakonshme këto gjashtë muaj.

Ka pasur shtatë dëgjime publike, ka pasur marrje të shumicës së rekomandimeve, duke i përfshirë shoqërinë civile vendore, institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Të gjitha ato rekomandime që kanë qenë përmbajtjesore, në këtë komision janë marrë parasysh. I keni raportin me amendamente. Do të kishte qenë mirë ta shihni gjatë votimit në lexim të dytë të këtij projektligji, i keni 93 amendamente. 93 amendamente nuk janë vetëm numër, por janë 93 amendamente që kanë ndryshim të përmbajtjes së projektligjit. Në këtë rast janë marrë parasysh edhe komentet e BE-së, të OSBE-së, si dhe të raportit të Këshillit të Evropës.

Po, çka është me rëndësi të thuhet tash këtu, është se nuk është e vërtetë që me këtë projektligj, e që në momentin që votohet bëhet ligj, cenohet pavarësia e mediave. Absolutisht, nuk ka cenim të pavarësisë së mediave. Ka përafrim të direktivës së Bashkimit Evropian, e cila është e vitit 2018, e ne ligjin në fuqi të KPM-së e kemi nga viti 2012. Pra, ka shumë rëndësi ato përafrime të standardizimit të çështjeve që janë shumë të ndjeshme dhe janë komplekse, sidomos për çështjen e mediave.

Unë ju rekomandoj që kjo pikë, kur të vijë rendi, të diskutohen të gjitha ato amendamente me atë përmbajtje që janë të nivelit që janë marrë parasysh çështjet kryesore dhe të ecim tutje të afrojmë ligjin me standardin evropian për çështjen e mediave, çështje kaq komplekse dhe sigurisht që çështjet që nuk janë adresuar deri tash, ose çështje që do të adresohen me direktivat e ardhshme të Bashkimit Evropian, t'i përafrojmë në vitet në vijim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Enver Hoxhaj.)

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon që Ligji për Komisionin e Pavarur për Media të tërhiqet.

Unë sapa dëgjova, siç e dëgjuat të gjithë, përfaqësuesin e mazhorancës. Tani ju thoni që keni koordinim me BE-në, në anën tjetër kemi reagim zyrtar nga BE-ja, i cili del kundër këtij projektligji.

Pra, cenimi i lirisë së mediave në vendin tonë është një prej goditjeve më të mëdha që mund t'i jepet agjendës sonë evropiane, po edhe zhvillimit tonë të brendshëm si shoqëri. Pra, unë besoj që sot ju duhet ta keni kurajën, pas reagimit të djeshëm, edhe për hir të agjendës sonë evropiane, edhe për hir të perspektivës sonë, që ky projektligj të tërhiqet nga rendi di ditës, ashtu siç propozoi kolegu nga Lidhja Demokratike. Të ulemi së bashku dhe ta gjejmë një frymë të përbashkët të komunikimit dhe, në fund, të mos jetë një diçka që do të na faturohet edhe në

raportin për vendin nga Bashkimi Evropian dhe që do të bëhet pengesë për integrimin e Kosovës më tutje në institucionet ndërkombëtare.

Prandaj, është definitivisht e palogjikshme që ne të vazhdojmë punën, edhe si Kuvend, edhe si opozitë, së bashku me juve në këtë Kuvend, nëse këto tri kërkesa, siç janë edhe kërkesat e Bashkimit Evropian, të vazhdojnë, pra, të largohen nga rendi i ditës dhe ne të qëndrojmë dhe të kemi një frymë bashkëpunimi me juve.

Pra, ne edhe një herë po ju kërkojmë që të reflektoni, ta votoni tërheqjen e këtij projektligji nga rendi i ditës, të ulemi të diskutojmë, t'i adresojmë shqetësimet e BE-së dhe të opozitës dhe pastaj të vazhdojmë seancën në rrjedhën e saj, sikurse e ka planifikuar Kryesia e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i AAK-së, zoti Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Deputetë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Sa u përket këtyre tri ligjeve, apo saktësisht Ligjit për media, mendoj se ajo që u tha nga kryesuesi i komisionit, apo kryetari i komisionit nuk qëndron, sepse kemi një kundërshtim të fuqishëm nga Bashkimi Evropian. Ndërsa, në anën tjetër, thotë se “Ligji nuk cenon të drejtat e mediave...” dhe këtu dikush nuk e thotë të drejtën.

Nëse ne synojmë integrimin në Bashkimin Evropian, nëse ne synojmë në organizata të tjera ndërkombëtare dhe, në anën tjetër, biem ligje në kundërshtim me atë që thotë Bashkimi Evropian, atëherë, mazhorancë, ku po e çoni Kosovën? Kah po ia mbani?!

Unë e di që ju po bëni zhurmë, po bëni punë, por ja që kjo puna juaj është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse kemi shumë ligje që janë kthyer mbrapshtë nga Kushtetuta dhe ju prapë vazhdoni rrugën tuaj. Më besoni, se do të na çojë diku në qorr-sokak dhe mendoj që tërë ajo punë e juaja po shkon huq, sepse po punoni pa logjikën dhe pa atë që po e kërkon Kushtetuta e vendit, demokracia dhe ajo që thuhet se ligjet të jenë për qytetarët dhe për ata që i implementojnë me të drejtë.

Prandaj, ne si Aleancë, themi që ligji t'i kthehet sponsorizuesit apo në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga kolegët e Grupit Multietnik?

Atëherë, e hedhim në votim. A mund ta di sa deputetë janë të pranishëm? Të pranishëm janë 77 deputetë, prandaj ju ftoj që të votojmë për propozimin e deputetit Selmanaj.

Kush është për?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar kolegë deputetë,
25 deputetë kanë votuar për propozimin e zotit Selmanaj, 50 deputetë janë kundër dhe ka 3 abstenime. Konstatoj që propozimi i zotit Selmanaj që të tërhiqet Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave nuk kalon.

Zoti Selmanaj, e keni fjalën për propozimin e tretë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Ashtu siç thashë edhe më herët, kërkojmë që edhe pika 22, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zyrtarë publikë, t'u kthehet komisioneve punuese, ose edhe më mirë Qeverisë, për shkak se kemi edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese që e ka shpallur kundërkushtetues këtë ligj disa muaj më parë dhe fatkeqësisht, i njëjti trend ka vazhduar.

Unë them kështu, duke parë edhe trendin e zhvillimeve të seancës, që keni zgjedhur të votoni kundër rekomandimeve të atyre që na kanë ndihmuar, edhe të ndërtojmë, edhe të konsolidojmë këtë shtet, LDK e sheh të panevojshme e të paarsyeshme që të bëhet pjesë edhe më tutje e një seance ku votohet kundër rrugës integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian, sepse jemi të bindur që ne nuk kemi formë tjetër, përpos vendimmarrjes dhe ligjeve që t'i tregojmë edhe BE-së se jemi në rrugë me ta, jemi me standardet e njëjta.

Ju po votoni kundër, ju keni vendosur rrugë tjetër, andaj LDK-ja, pas këtij votimi që po i dimë edhe rezultatet, e sheh të paarsyeshme e të panevojshme që të jetë pjesë e kësaj krahure, po e quaj, fatkeqësisht për vendin, që dikush ka zgjedhur të votojë kundër standardeve të BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Vetëvendosjes.

VALON RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Edhe për Projektligjin për KPM-në, po edhe për këtë për zyrtarët publikë, asnjë argument përfaqësuesit e partive politike nuk e dhanë, se përse duhet të tërhiqet ky projektligj prej rendit të ditës. Së paku një argument. Argument i tyre i vetëm është të tërhiqet se është në kundërshtim. Cila është pika kundërshtuese? As këtu ku u fol sot, as në ato dëgjimet publike, as në ato seancat

e komisionit nuk e kanë argumentuar pse duhet të mos jetë kështu, vetëm kanë thënë se janë kundër.

Te çështja e Ligjit për zyrtarët publikë. Po, është shumë e vërtetë që ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe ky plotësim-ndryshim 90% e ka qëllimin e adresimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Janë edhe dy-tri nene të tjera që janë plotësuar e ndryshuar e që rekomandimi, edhe i BE-së, ose i Zyrës së BE-së, ka qenë për komplet Ligjin e zyrtarëve publikë. Domethënë, ka diku afër 30 faqeve ai rekomandim, nuk flet me këto tetë nene, sa i ka ky plotësim-ndryshim, por flet për komplet ligjin që është në fuqi, i cili nuk është objekt i trajtimit në këtë projektligj, janë vetëm tetë nene.

Kështu që, unë propozoj që të mbetet ky rend dite, të plotësohet e të ndryshohet me këto amendamente. E për ligjin në fuqi, sigurisht se në të ardhmen do të ketë mundësi të plotësohen e të ndryshohen edhe ato nene që janë të argumentueshme, por jo kështu pa asnjë argument të thuhet se duhet të tërhiqet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës.

ISAK SHABANI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashura media,

Shqetësimet i dëgjuam që janë në vazhdimësi, të Bashkimit Evropian, të Avokatit të Popullit dhe të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe sindikatat e zyrtarëve publikë, apo shërbyesve civilë.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 14.9.2023 është dhënë afat gjashtëmuor për të harmonizuar këtë projektligj me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Po përkundrazi, edhe pse më 14 shtator 2023, sot jemi në muajin e dhjetë që kjo nuk ka ardhur në rend të ditës. Po, çka ndodh më tutje? Përveç se Qeveria nuk merret me harmonizimin e ligjit me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ajo shton edhe shumë çështje të tjera në plotësim-ndryshim të këtij ligji.

Prandaj, është shumë e arsyeshme që ky projektligj gjithashtu, të tërhiqet dhe me siguri edhe ne i përkrahim të gjitha ato organizata që kanë thënë se ky projektligj nuk është i mirë për Kosovën.

Po i përmend vetëm nja tri çështje, shumë shkurt. Gjykata Kushtetuese rikujton opinionin e Zyrës Ligjore të BE-së, në të cilin thekson se asnjë administratë nuk i jep fund punësimit të një drejtuesi të njësisë me performansë të mirë, vetëm sepse duhet që një mundësi t'u ofrohet kandidatëve të tjerë, potencialisht më të mirë, si dhe prezantimi i mandateve nuk do të adresojë asnjë problem kyç, me të cilat përballlet Administrata e Kosovës, veçse do të krijojë jostabilitet dhe pasiguri.

Sigma, e cila ka marrë pjesë me milionë euro në krijimin e Administratës Shtetërore sot në Kosovë, gjithashtu thotë se sa i përket reformës së Administratës Publike, ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, respektivisht mandat katërvjeçar, ka mbajtur qëndrim kundër. Lidhur me këtë Sigma specifikon se mandatet në detyrë për nëpunësit civilë në pozitat drejtuese nuk janë të zakonshme në administratat e vendeve të BE-së dhe në mënyrë artikulare as nuk shihen në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues.

Edhe Avokati i Popullit konsideron se vendosja e udhëheqësve të ulët dhe të mesëm drejtues në pozita të karrierës, në pozitë mandatare, jo vetëm që cenon qëndrueshmërinë e shërbimit civil, por edhe pritshmërinë legjitime, sepse themelimi i marrëdhënies së punës është realizuar nëpërmjet rregullave, legjislacionit, të cilat kanë garantuar kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës.

Përndryshe, edhe nëse komision do të ishte mirë ta pranojmë të tërhiqet, për arsye se disa amendamente që i ka shtuar Qeveria janë në kundërshtim me aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese. Përkundër kësaj, nëse kjo vazhdon tutje, me siguri ne do ta shqyrtojmë mundësinë për ta dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e do fjalën dikush?

PAL LEKAJ: Po shihet qartë se mazhoranca nuk e ndryshon vendimin dhe ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahim mocionin procedural për këtë ligj që të kthehet te Qeveria. Dhe, nëse prapë ju nuk jeni ata që mund të bashkëpunoni me opozitën, atëherë nuk di pse opozita do të rrijë sot në sallë.

Prandaj, ju vazhdoni me tuajën, por ta dini që jeni larg-larg synimeve, edhe të Kosovës, por edhe të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Me këtë sjellje, me këtë qasje, mendoj që ju po e mendoni veten si të ishit fuqia e botës, por ja që nuk jeni.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Multietnik? Atëherë, a mund të di se sa deputetë janë në sallë?

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju lus për mirëkuptim! Unë e di që jemi këtu në tavan dhe pagës e krijon ndjenjën e ajrit, por ju lus që ta kemi një atmosferë më dinjitoze të punës, para se ta ftoj seancën që të marrë qëndrim përmes votës, më lejoni që t'i uroj mirëseardhje deputetes Ganimete Musliu!

(Duartrokite)

KRYESUESI: Ju dëshiroj sukses! Jemi të lumtur që shërimi dhe shëndeti është stabil, sikur që Ganja ka qenë çdo herë stabile dhe e fortë.

Në sallë janë të pranishëm 75 deputetë. Prandaj, ju ftoj që të votojmë:

Kush është për propozimin?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Rezultati sa i përket këtij projektligji. Propozimi ishte për t'u tërhequr pra, është 25 vota për, 50 kundër dhe 3 abstenime. Kuorumin e kemi pasur, por propozimi nuk kalon.

Qetësi, ju lutem!

Nuk kalon propozimi, kështu që kalojmë.

Po kalojmë te pika:

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Të nderuar deputetë,

Deklarimin në emër të Vetëvendosjes e ka deputetja Arbëresha Kryeziu-Hyseni. Urdhëroni!

ARBËRESHA KRYEZIU-HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të dashur kolegë deputetë,

Drejtësia nuk është matematikë prej të cilës ne nxjerrim mesataren e të dy anëve, sepse pozicionet...

KRYETARI: Qetësi, se në këtë sallë shumë pak po dëgjohet. Deputetë, ju lutem!

ARBËRESHA KRYEZIU-HYSENI: Drejtësia nuk është matematikë prej të cilës ne nxjerrim mesataren e të dy anëve, sepse pozicionet ngjarjet në veri të vendit ishin të qarta. Kosova që angazhohet për rend, ligj e kushtetutshmëri, dhe Serbia në anën tjetër që nxiste pa ndërprerë bandat kriminale që sulmonin institucionet tona të sigurisë, KFOR-in, gazetarët dhe qytetarët atje.

Pra, kur flasim për masat e vendosura nga Bashkimi Evropian, është parësore të adresohen nuancat politike që qëndrojnë në themel të këtyre veprimeve. Pra, është evidente se masat e vendosura janë përmbajtjesisht të natyrës politike sesa ekonomike dhe vazhdimi i tyre sikurse

qysh në fillim dhe vendosja e tyre është edhe e padrejtë edhe e paarsyeshme. Pra, Kosova ishte në të drejtën e saj.

Sot, në katër komunat e veriut rrugët janë të hapura, ofrohen shërbimet komunale, ka filluar pagesa e energjisë elektrike, janë hapur zyrat kadastrale, ato të regjistrimit civil dhe ato të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve. Është lansuar masa e punësimit për dy mijë banorë të komunave të veriut e janë dhjetëra shtëpi të ndërtuara atje me subvencionimin qeveritar.

Në veri pra ka ndodhur deeskalimi. Besoj që qëndrimin e qartë që duhet ta ndjekin të gjitha shtetet, e ka dhënë zëvendëspresidenti evropian Josep Borell, që ka thënë se edhe ato arsye dikur të konsideruara, nuk ekzistojnë më. Ne si Kosovë më shumë se kaq nuk mund të bëjmë. Ndërkohë, është e habitshme dhe në të njëjtën kohë e pashpjegueshme se pse për mbi një dekadë Bashkimi Evropian nuk ka marrë një qëndrim më të fortë ndaj dikujt që e ka kthyer eskalimin, gjuhën nxitëse, atë të urrejtjes në një lloj arti e ky është presidenti i Serbisë, Vuçiq.

Mos të harrojmë, Serbia ka sponsorizuar një bojkot zgjedhor në Kosovë, ka kidnapuar oficerë e policë të Kosovës, ka pajisur, ka trajnuar dhe ka organizuar një sulm në Banjë të Zveçanit, ndërsa në Serbi ka keqtrajtuar protestuesit dhe ka zhvilluar zgjedhjet e veta jo të lira dhe të vjedhura.

Serbia mbështet forcat proruse në rajon, flet hapur për pretendimet për ndarje të Bosnjës dhe për Serbinë e madhe, vazhdon të refuzojë të miratojë sanksione ndaj rusisë dhe mban si aleat kyqë autokratët si Orban, Aliev, Lukashenko, Putin dhe Xi, por BE-ja po pretendon se Beogradi ka përqaftuar perëndimin.

Të dashur kolegë,

Për dallim, Bashkimi Evropian të Kosova e gjen partnerin dhe aleatin më të sigurtë në rajon të parimeve demokratike dhe interesave afatgjate. Kosova të tillë e ka Qeverinë dhe të tillë e ka edhe popullin. Angazhimi ynë i vazhdueshëm në dialog dhe përpjekja drejt normalizimit me Serbinë përballë mosrespektimit dhe veprimeve agresive të Serbisë, thekson edhe më shumë padrejtësinë e këtyre masave të vendosura tash e një vit ndaj Kosovës.

Vlen të theksohet edhe një herë se institucionet tona kanë bërë përparime të rëndësishme në indeksat e shumta ndërkombëtare të demokracisë dhe sundimit të ligjit, duke e udhëhequr Ballkanin Perëndimor në aspekte të ndryshme nga përmirësimi i shtetit ligjor dhe luftimi i korrupsionit.

Si përfundim, heqja e këtyre masave nuk është thjeshtë një domosdoshmëri, por është një kërkesë urgjente. Kjo do t'i mundësojë Kosovës të vazhdojë rrugën e saj të integritetit dhe

reformave në Bashkimin Evropian, të përshpejtojë angazhimet tona dhe të fillojë procesin drejt arritjes së statusit të kandidatit në Bashkimin Evropian.

BE-ja duhet të angazhohet në mënyrë më konstruktive me Kosovën, duke njohur përpjekjet dhe kontributet tona drejt stabilitetit rajonal dhe avancimit demokratik. Nga ana e Kosovës gjithçka është kryer, zbatuar për normalizimin dhe deeskalimin e situatës. Prandaj, e keni rekomandimin e shefit të diplomacisë evropiane, Borell, të cilin urojmë që pa vonesë shtetet anëtare ta miratojnë dhe Kosovës t'i hiqen përfundimisht masat e vendosura padrejtësisht tash e një vit. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Multietnik e ka kërkuar fjalën. Duda Balje flet.

DUDA BALJE: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Ja hoću da kažem da je ovih poslednjih dana u Opštini Prizren i Opštini Dragaš i selima ovih opština bila elementarna nepogoda sa kišom i gradom. Znači padala velika kiša, padao je grad, ima velikih šteta u poljoprivrednom zemljištu, ima velike štete u kućama, prelili su reke, ljudi su uplašeni, postoje kuće koje se nalazi pored reke, a znači treba stvarno hitno da se deluje.

Zato molim Vladu, ministra Finansija, jer su timovi organizovani na lokalnom nivou i rade procenu štete, ali ipak finansiranje i sve što treba da se uradi mora da se uradi sa centralnog nivoa.

Pra, dua të them se këto ditët e fundit, në Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Dragashit dhe fshatrat e këtyre komunave kanë pasur një fatkeqësi natyrore me shi e breshër. Prandaj, i lutem Qeverisë, ministrit të Financave, sepse nga niveli lokal janë organizuar ekipet të cilat janë duke e bërë vlerësimin e dëmeve, por prapëseprapë financimi dhe krejt çka duhet të bëhet, duhet të bëhet prej nivelit qendror.

Prandaj, i lutem ministrit dhe Qeverisë që ta marrin me seriozitet më të madh, sepse njerëzit vërtet janë jashtë vetes. Edhe sot moti nuk është mirë lart dhe mund ta kemi gjendjen edhe më të keqe. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, sërish Vetëvendosja. Flet deputeti Adnan Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas gjashtëmbëdhjetë muajsh, dje më 26 qershor 2024, Gjykata Kushtetuese e Kosovës njoftoi që për pjesët e katër neneve dhe me pesë vota për dhe katër vota kundër ka shpallur të

pavlefshëm në tërësi Ligjin për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Pas vonesës së pashembullt, njoftimi i djeshëm pa dyshim është goditje e madhe për reformën dhe sistemin e drejtësisë fillimisht, dhe për qytetarët që presin jetësimin e reformës në anën tjetër.

Kjo nismë ka për qëllim luftimin e pakompromis të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ka për synim themelimin e një organi siç është Byroja, e cila do të verifikojë pasurinë e zyrtarëve publikë të fituar në mënyrë të paligjshme nga taksat e qytetarëve.

Qëllimi i hartimit të këtij ligji ka të bëjë me çrrënjosjen e korrupsionit, të cilin e kanë rrënjosur për vite me radhë aktorë dhe faktorë që kanë qeverisur me institucionet publike të vendit.

Për më tepër, ligji ka si qëllim të fundit kthimin e taksave të qytetarëve, të cilat janë përvetësuar në mënyrë të paligjshme nga zyrtarë dhe ish-zyrtarë publikë që kanë punuar dhe punojnë në institucionet publike të Republikës së Kosovës. Që nga marrja e mandatit, përkushtimit dhe angazhimi ynë ka qenë dhe mbetet lufta ndaj korrupsionit dhe dukurive që e kanë gërryer pasurinë publike. Pavarësisht pengesave të llojllojshme ligjore dhe joligjore, të bëra nga qare opozitare dhe grupe të interesit, reforma e tillë dhe ky prioritet yni do të bëhet.

Jemi të vendosur më shumë se kurrë që të tejkalojmë secilin obstrukcion, me qëllim që sundimi i ligjit të gjejë hapësirë në vendin tonë. Një gjë që duhet pranuar është fakti se Gjykata Kushtetuese po shfrytëzohet si instrument i vonimit apo pamundësimit të reformave të nevojshme.

Konkretisht, qëllimi i vetëm i dërgimit të Ligjit për Byronë ka të bëjë me ruajtjen e pasurisë së pajustificueshme, të përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme nga zyrtarë të lartë publikë e politikanë, të cilët po mundohen të mbrojnë pasuritë e tyre. Kjo tentativë e tyre do të dështojë pa dyshim dhe kthimi i pasurisë së tillë publike në buxhetin e shtetit do të ndodhë.

Duhet rikujtuar se nisma e tillë reformuese dhe koncepti i konfiskimit civil kishin marrë vlerësimin e trefishtë nga Komisioni i Venedikut dhe po ashtu ishte punuar nga ekspertë eminentë vendorë dhe ndërkombëtarë. Përderisa dy opinionet e para jepnin rekomandimet e duhura profesionale, e të cilat u inkorporuan tërësisht në ligj, opinioni i tretë validonte ligjin se plotësonte standardin e lirive dhe të drejtave të njeriut, të përcaktuara me konventat ndërkombëtare dhe përgëzonte autoritetet e Kosovës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Venedikut.

Pavarësisht standardit profesional, mbi të cilin ishte hartuar ky ligj dhe rëndësisë së reformës, duket që motivi për të mbrojtur pasurinë e paligjshme ka qenë i fortë. Ashtu siç ka qenë pasurimi i shpejtë e keqpërdorimet e mëdha të zyrtarëve publikë.

Sido qoftë, sado që vonesa e dëmton drejtësinë, askush që ka përfituar paligjshëm nuk mund të fshihet pas Gjykatës Kushtetuese e as pas pasurisë së paligjshme, sado e madhe që të jetë ajo.

Ata që po besojnë se përmes Gjykatës Kushtetuese do të pamundësojnë konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, e kanë shumë gabim. Po e mashtrojnë veten se mund ta mbrojnë pasurinë e paligjshme. Vonim mund të ketë, por shpëtim nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme nuk ka.

Kundër kësaj nisme të rëndësishme kanë votuar pesë gjyqtarë të kësaj gjykate nga gjithsej nëntë të tillë. Përderisa katër të tjerë menduan se nisma ligjore ishte në përputhje me standardet kushtetuese dhe profesionale. Pra, këta gjyqtarë nxorën një vendim që nuk arritën të bindin as kolegët e tyre gjyqtarë, duke e shpallur ligjin të pavlefshëm, me vetëm një votë më shumë nga ata që kanë menduar dhe votuar që ligji është në përputhje me Kushtetutën.

Edhe njëherë duhet ritheksuar dhe kjo është goditje pa dyshim ndaj luftës kundër krimit të organizuar e korrupsionit, e cila vazhdon ta bllokojë e vonojë tutje zhvillimin e vendit dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Por, përfundimisht, ne jemi të përkushtuar që të mos heqim dorë nga kompletimi i reformës së tillë e cila e lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ne do të vazhdojmë tutje, ta jetësojmë këtë nismë duke bërë ndryshimet e nevojshme, në përputhje me standardet profesionale vendore dhe ndërkombëtare, duke kontribuar tutje për një shtet dhe shoqëri ku sundon rendi e ligji, e ky natyrisht fenomeneve të tilla të keqpërdorimit të detyrës zyrtare e të pasurimit të zyrtarëve të lartë publikë nga pozitat zyrtare, të marrin përgjigje institucionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Edhe Jeta Statovci flet tash.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Pa dyshim që një prej sektorëve më të rëndësishëm, mirëpo që kishin trashëguar gjendjen më të dhimbshme të performansës ishin ndërmarrjet publike. Nga shtatëmbëdhjetë ndërmarrjet publike, të cilat i raportojnë Ministrisë së Ekonomisë, tashmë dhjetë prej tyre e kanë përmbyllur vitin me fitim financiar, e që më parë ishin vetëm dy.

Është punuar në vazhdimësi për të përmirësuar gjendjen e tyre financiare, për të siguruar plane të qarta të biznesit, për të rishikuar strukturën organizative, në mënyrë që të ndihmohet afarizmi i

tyre, si dhe për të siguruar menaxhim të duhur e burime njerëzore dhe për të zvogëluar shpenzimet e për të rritur të hyrat.

Ndërmarrjet publike e kanë mbyllur vitin 2022 me një fitim të jashtëzakonshëm prej 101,4 milionë euro dhe me trend pozitiv i cili ka vazhduar tutje. Për ilustrim, në periudhën 2015-2017, humbja ishte 55,6 milionë. Në periudhën 2018-2020, humbja ishte 26 milionë. Kurse, përgjatë periudhës 2021-2023, fitimi është mbi 120 milionë euro.

Telekomi u gjend me afër 17 milionë euro humbje, si dhe me një varg shpenzimesh marramendëse. Vlen të përmendet se aty u gjendën rreth 323 pozita të avancuara, të cilat i potencoi edhe Auditori, të avancuara vetëm me vendime nga grada 5 në 15 dhe duke shpërfillur të gjitha procedurat e tjera. Ato u rishikuan dhe i kursyen Telekomit rreth treqind mijë euro në muaj vetëm me këtë rishikim. Kishte qira marramendëse, kur kujtojmë dhe këto zyre të Telekomit përreth Kuvendit, e ku qiratë mujore të tyre shkonin deri 26 mijë euro.

Në sektorin e ujërave, KRU Prishtina tashmë shënon inkasim rekord. Jo vetëm të asaj se çka faturon, mirëpo edhe të borxheve paraprake, të cilat ishin trashëguar.

Ibër-Lepenci i cili ishte njohur me storie relativisht të famshme sensitive, tashmë për herë të parë që nga 2008-ta po rezulton profitabile, në rimëkëmbje e sipër edhe me plane të mëtutjeshme të avancimit të infrastrukturës së saj dhe të kapaciteteve të saj gjeneruese.

KEK-u ka dalë ndërmarrja me performansën më të mirë financiare, kryesisht falë prodhimit të lartë të energjisë elektrike dhe uljes së shpenzimeve operative.

Gjatë v. 2022, KEK-u ka përgatitur gjithashtu dhe planin me kapacitet 100 MW për parkun diellor, që paraqet projektin e parë të ndërmarrjes për diversifikim të burimeve të prodhimit të energjisë e që është në përputhje edhe me Strategjinë sektoriale të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, KEK-un për herë të parë e ka audituar Zyra Kombëtare e Auditimit, përderisa në pesë vitet e fundit, ndoshta edhe më gjerë, është audituar nga kompani private.

Trepça për herë të parë është audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit me një auditim të performansën.

Gjithashtu, edhe Ibër-Lepenci pas gjashtë viteve të auditimit nga kompani private, tashmë po auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pikërisht këto rezultate tashmë e dëshmojnë qartë përkushtimin tonë për të ndërtuar një ekonomi të fortë dhe të drejtë. Rezultatet tregojnë se me qeverisje të mirë dhe me politika të duhura, ne

mund të arrijmë rezultate të mira dhe të sjellim ndryshime si për këto ndërmarrje si dhe për qytetarët tanë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Dimal Basha e ka kërkuar fjalën po ashtu.

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Meqenëse u bisedua për projektligjet që i kërkoi opozita të tërhiqen, mirëpo si deputetë nuk e patëm rastin ta marrim fjalën, po vetëm grupet parlamentare, atëherë unë veç shkurt dua të përmend Ligjin për KPK-në, ku u tregua këtu që ka pasur edhe një letër prej BE-së, ku BE-ja ka dilema. Duke e marrë parasysh që grupi punues i ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet, edhe të Komisionit të Venedikut, po edhe BE-ja ka qenë aty e pranishme, mirëpo ata i kanë dilemat e tyre, derisa ne nuk i kemi këto dilema më tutje.

Fatkeqësia është që prej opozitës nuk ka asnjë vërejtje përmbajtjesore. Veç thotë na e ka çuar një letër BE-ja dhe tërhiqë ligjin, mos e bëni. Kjo tregon më shumë që këta e kanë për synim pengesën e reformës në drejtësi, sesa të jenë pjesë e një rregullimi të një reforme që ne po e synojmë.

Për më tepër, nuk kanë marrë pjesë as në grupe punuese opozita që kanë qenë të ftuar. Në të njëjtën kohë, tash thonë: kthejeni dhe e rregullojmë. Tash, edhe po të duam ta kthejmë, ata nuk marrin pjesë në grupe punuese. Kjo tregon më shumë që janë pjesë e një pengese sesa të një rregullimi të mundshëm.

Kështu që, çka po dua të them, është se, sikurse te KPK-ja, njëjtë edhe te Byroja, më shumë është farsë për të penguar reformën, sesa të jenë pjesë e një rregullimi.

Tjetër, te KPM-ja. U thanë shumë propaganda dhe është bërë shumë mediale çështja e Ligjit për Këshillin e Pavarur të Mediave. Aty thonë se duam të kapim edhe mediat. Duhet kuptuar një send. E para, televizionet veç u nënshtrohen Ligjit të KPM-së edhe kurrë s'ka pasur asnjë ankesë prej tyre. Mirëpo, portalet s'kanë dashur. Tash kur u bë zgjerimi, janë përfshirë edhe portalet aty, kanë dalë e po bërtasin, s'po duan të jenë pjesë e asnjë rregullimi.

Mendoj nuk është në rregull, për shkak se edhe furrat e bukës kur hapen në këtë republikë, duhet të deklarohen, duhet të deklarohen punëtorët, duhet të deklarohen tatimin, duhet të deklarohen gjithçka tjetër. Kjo është e para.

E dyta, po na flet dikush për kapje të mediave, që ne e dimë që Telekomini siç e tha edhe kolegja, e kanë falimentuar Telekomini me pesëdhjetë milionë euro humbje dhe kanë shkuar nga dhjetë milionë euro ua kanë dhënë mediave. Pse? Për t'i blerë ato për të folur. Kjo Qeveri është e

vetnija Qeveri që ua ka ndalë komplet tagjinë dhe asnjë cent nuk u shkon më mediave. Kështu që, po të donte t'i kapte, do të vazhdonte avazin e vjetër. Po ndryshimi tregon që ne s'jemi të asaj rruge dhe s'kemi synim ta kapim.

E fundit, po besoj që ka rëndësi ndonjëherë edhe kush flet. Unë e kuptoj, p.sh. e kemi Flutura Kusarin, del edhe do ta diktojë komplet Kuvendin e Kosovës qysh ta bëjmë ne një ligj për KPM-në, kur ai njeri në emër të lirisë së mediave, del dhe i mbron Devollët në rrugë.

d.m.th. në emër të lirisë së mediave, nuk mund ta mbrosh lirinë e oligarkëve, të shpifet, po as të zhvatë këtë republikë, të njëjtën kompani që deri dje e kanë marrë homologimin, i kanë marrë këto терминаlet doganore që ne jemi duke ia kthyer shtetin.

Kolegë të nderuar,

Kështu që, mbrapa krejt kësaj, ne duhet shtyrë këta ligje, për shkak se prapa kësaj fshihen shumë të zeza e shumë sende të pasinqerta, të cilat hidhen në publik, kinse në interes të publikut, por ata veç interesin e publikut nuk e mbrojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse nuk kemi të tjerë të paraqitur, kalojmë te pika:

3. Pyetjet parlamentare

Pyetjen e parë parlamentare e kanë pasur. Nuk dua t'i lexoj ata që nuk janë të pranishëm, sepse kemi shumë. I kemi shtatëdhjetë. Do të shkojmë vetëm te ata që i identifikuaam paraprakisht që i kemi këtu të pranishëm.

Po shkojmë drejt e te deputeti Jahja Kokaj. Profesor, nuk e ke Liburnin këtu, veç nëse e ke patjetër pyetjen ta lexosh, se ministrin nuk e ke.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të pranishëm,

Me respekt të veçantë,

Qytetarë të nderuar,

Unë po e shoh që ministri nuk është këtu, po e ndjej të nevojshme dhe me urgjencë serioze që të prezantojë situatën e rrugës që vjen prej Gjakovës nga Dollci deri në Rakovinë dhe brengën e madhe të qytetarëve që shprehen edhe me mllef për një situatë shumë drastike. Në mënyrë të pamëshirshme operatori atje e bën shkatërrimin e asfaltit ekzistues dhe pastaj tërhiqet për dy muaj nuk shihet atje, vetëm do rërë e kanë hedhur atje, do gurë në të vërtetë.

Prandaj, ma merr mendja që duhet të ndërmerret diçka ndaj atyre operatorëve. Unë e kuptoj që Ministria nuk ka këtu faj, por operatorët po sillen në mënyrë jomiqësore më së pari ndaj qytetarëve atje, që rrënojnë rrugën, pastaj rrinë në mënyrë indolente derisa të vijë dimri.

Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe herën e kaluar, prandaj desha ta sensibilizojë këtë situatë. Faleminderit! Kur të vijë ministri, ia bëj ndoshta pyetjen në mënyrë konkrete.

KRYETARI: Arjeta Fejza për të njëjtin ministër. Ministrin nuk e kemi këtu.

Vazhdojmë! Mirlinda Tishukaj-Sadiku, për ministrin. Nuk e kemi ministrin këtu.

Pyetja 49 e Agon Batushës për ministrin Aliu. Nuk e kemi këtu ministrin. Po.

Pyetja nr. 55 është e deputetit Arbër Rexhaj, i cili po ashtu e ka pyetjen për ministrin Aliu.

Erdhi ministri Aliu, kështu që mund t'u kthehem pyetjeve.

AGON BATUSHA: Atëherë,

I nderuar ministre,

Është bërë një bujë e madhe për çështjen e disa projekteve infrastrukturore në zonën e qytetit të Sharrit, duke përfshirë disa rrugë të rëndësishme, siç është ajo Zhur-Bord, por edhe investime në fshatrat që lidhin brezin kufitar Kosovë-Shqipëri nga ajo pjesë.

Është vërejtur një përpjekje nga qeveria lokale për të shpërfaqur një tip mungese vullneti për përkrahje veçanërisht të projekteve që janë në zhvillim në brezin kufitar, duke i cilësuar si të vendosura nga Ministria dhe jo si kërkesë nga komuna atje.

Ne e dimë që zhvillimi infrastrukturore i asaj zone është i rëndësishëm edhe për potencialin e zhvillimit turistik që ka, përveç aspektit kombëtar, ka rëndësi tjetër po ashtu të veçantë.

Për opinionin publik, a mund të dimë gjendjen e mëparshme, situatën aktuale dhe ecurinë e projekteve, e rrugëve që po asfaltohen në brezin kufitar atje. Kjo përfshin edhe pyetjen shtesë që e bëra. D.t.th. i ke dy pyetje.

KRYETARI: Ministri Aliu përgjigjet.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet,

Faleminderit për pyetjen!

Në vitin që lamë pas kanë përfunduar punimet në lotin e parë të rrugës Zhur-Dragash, meqenëse në kontratën fillestare nuk ka qenë i kontraktuar sinjalizimi i këtij segmenti. Aktualisht, kemi

filluar procedurat për të vendosur edhe sinjalizimin, i cili do të përfundojë këtë vit së bashku me punimet në lotin 2 të kësaj rruge.

Ndërsa, për sa u përket rrugëve të cilat lidhin lokalitetet me zonat në fshatrat në Shqipëri, me Republikën e Shqipërisë pra, ne kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e shtetit, respektivisht Republikën e Shqipërisë, për herë të parë investohen rrugë të cilat i lidhin dy anët e kufirit. Pra, punët kanë filluar në rrugën Kërstec-Pakishë-Zapod dhe janë duke u zhvilluar sipas planit të paraparë.

Bazuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e Republikës së Shqipërisë, në të ardhmen do të vazhdojmë edhe me aktivitetet e ndërtimit në rrugën Pogaj-Gorozhup, ndërsa pala shqiptare atë Dobrunë-Blinishtë.

Sa i përket rrugës Pogaj-Gorozhub, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, javën e kaluar ka iniciuar edhe procedurat e prokurimit. Pra, kemi të bëjmë me fshatra në të dy anët e kufirit, të cilat si rezultat i kufirit janë izoluar mes vete. Mos të harrojmë se këto fshatra kanë jetuar normalisht, banorët e këtyre fshatrave kanë jetuar normalisht. Për qytetarët e Malësisë në veriun e Republikës së Shqipërisë dhe ata në jugun e Republikës së Kosovës kanë jetuar bashkë para se të bëhet ai kufi.

Qyteti i Prizrenit, qyteti Gjakovës kanë qenë qytete të këtyre zonave. Kufiri i vendosur padrejtësisht, aty i ka izoluar këto fshatra. Shumë prej këtyre fshatrave më larg e kanë Kukësin, sesa që i kanë zonat urbane këtej kufirit. Në këtë rast, konkretisht fshatrat Pakishë e Zapod janë jashtëzakonisht të izoluar në veriun e Republikës së Shqipërisë.

Dhe, për këto fshatra është jetike, si të themi, që të kenë qasje në rrugë të asfaltuar e të mund të dalin në pjesën e Sharrit, Dragashit në këtë rast. Dhe, duke i hapur këto pika të kalimit kufitar që të mund të kalojnë pa problem banorët e këtyre anëve.

Ne jemi marrë vesh që investimet e kësaj rruge edhe në pjesën e Republikës së Shqipërisë të kryhen nga ana e Kosovës, dhe unë mendoj që ka qenë një marrëveshje jashtëzakonisht e dobishme për qytetarët. Po ashtu, Republika e Shqipërisë do të ketë investim te pjesa e Dobrunës që e thamë, e që unë besoj që shumë shpejtë do t'i inaugurojmë edhe këto dy rrugë, ndërsa tjetër, atë të Gorozhubit, e thamë që sapa e kemi filluar procedurën e prokurimit. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë te pyetja e zotit Kokaj. Zoti Kokaj, ministër i nderuar, e bëri pyetjen e tij më herët. Tashmë e ka bërë pyetjen e tij. Besoj që e ke aty diku përgjigjen. Nëse keni përgjigjen për zotin Kokaj për çështjen që e ka ngritur, atëherë lirisht po.

MINISTRI LIBURN ALIU: Përgjigjja për deputetin Kokaj është pothuajse mbase e njëjta. Përpjekje të vazhdueshme, telashe të pandërprera në rrugën më problematike që e kemi në vend.

Dy rrugë më problematike që janë, është kjo Dollc-Gjakovë, ku jemi duke bërë përpjekje për t'i zgjidhur, për t'i evituar problemet në vazhdimësi. Ato dalin vazhdimisht. E njëjtë, e ngjashme situata është edhe me Gjilanin.

Te kjo e Gjilanit së paku ka një progres më të matshëm, ndërsa për sa i përket rrugës Dolc-Gjakovë problemet janë pothuajse gati të përditshme.

Dhe, është një rrugë të cilën e kemi trashëguar, dhe jemi duke luftuar, si të themi, çdo ditë. Stresin më të madh që na e ka shkaktuar dhe telashtet më të mëdha që na i ka shkaktuar në ministri është pikërisht kjo rrugë, e cila është kontraktuar pa u zgjidhur problemet. Një pjesë e madhe e problemeve të shpronësimit janë të pazgjidhura njëherë për njëherë dhe do të mbesin edhe për një kohë ashtu. Pjesët e tjera ku do të mund të realizohet jemi duke synuar që t'i kryejmë sa më shpejtë këto punime.

KRYETARI: A keni pyetje shtesë zoti Kokaj? Urdhëro!

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zoti ministër!

Unë po e kuptoj që ju personalisht nuk keni faj, por po them operatori i cili funksionon atje, i rregullon ato rrugë në thonjëza, po silllet, të thashë, në mënyrë pak më të butë, jo miqësore ndaj popullit, ndaj udhëtarëve që vijnë në Gjakovë-Prishtinë, përkatësisht Gjakovë-Dollc.

E rrënojnë 6 km atje, dhe e lënë dy muaj, tre muaj në mënyrë indolente, kurrfarë bageri, kurrfarë makinerie s'ka atje, përveç disa grumbuj të rërës atje.

Prandaj, ma merr mendja që është koha e fundit, dhe të njëjtën situatë e kishim edhe vitin e kaluar. Me urgjencë e rregulluan, tash ajo punë që u krye, asfalti u krye, i cili është kryer para dy muajve, prapë është shkatërruar dhe gropat janë të çuditshme pikërisht në asfaltin e posa përfunduar.

Prandaj, ky operator po silllet ta hem në mënyrë troç, armiqësore ndaj popullit të Gjakovës dhe qytetarëve që qarkullojnë atje dhe rrezikojnë edhe jetën. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni ministër nëse keni nevojë!

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet, do ta kem plotësisht parasysh këtë që po e thoni, dhe mbase personalisht do të dalë të informohem vet direkt në vend.

KRYETARI: Pyetja ishte për ministrin, ajo e mëhershme.

ARJETA FEJZA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Banorët e lagjes Bajr janë përballur me një sfidë të jashtëzakonshme pas vërshimeve në qytetin e Mitrovicës. Një pjesë e kësaj lagjeje, më saktësisht afër stacionit policor “Enver Zymberi” ka pasur lëvizje të dheut duke dëmtuar disa shtëpi.

Nga ekspertët që ka angazhuar komuna, e me të cilët së bashku me banorët edhe jemi takuar me ta, thonë që lloji i lëvizjes së tokës nuk thjesht një rrëshqitje e dheut, por më saktë një pasojë e ndërrim të rrjedhave të ujërave nëntokësore.

Pyetja është kjo, i nderuar ministër: duke kuptuar ndarjen e kompetencave, sigurisht midis komunës dhe ministrisë, a mund të na informoni se çka mund të bëhet për të ndihmuar këta banorë që në planin afatgjatë të mos ketë përsëritje dhe zgjerim të këtij problemi?

KRYETARI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI LIBURN ALIU: E nderuar deputete,

Në lidhje me problemet e rrëshqitjes së dheut në Bajr të Mitrovicës jam njoftuar edhe më herët. Jam njoftuar edhe nga deputetët e tjerë të zonës. Dhe, për këtë jemi në komunikim. Është në kompetencë të Shërbimit Gjeologjik të bëjë atë pjesën e studimit, ku pastaj në bazë të atij studimi ne do të mund të bëjmë intervenimin.

Përndryshe, ministria e ka gatishmërinë që t’u dalë ndihmë banorëve dhe të intervenojmë. Po presim një rezultat nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ku është në kompetencë të tyre analiza e situatës. Pjesa e ekspertizës i bie të jetë në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

KRYETARI: Pyetjet shitesë, deputete Fejza? Jo. Atëherë, dalim te deputetja Mirlinda Tishukaj-Sadiku. Mund t’i bëni të dyja pyetjet pra.

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për kolegët,

Mediat,

Qytetarë të Republikës.

Ministër, në qershor të vitit 2021 ishte publikuar një raport i një grupi punues, i cili është themeluar pikërisht nga ju në atë kohë, lidhur me procesin e ligjshmërisë së ndërtimit të hidrocentraleve në Kosovë, që në mostra ka qenë 21 gjithsej, ku në atë raport janë konstatuar shumë shkelje ligjore lidhur me ndërtimet dhe vënien në funksion të këtyre hidrocentraleve.

Në mesin e këtyre hidrocentraleve, të cilat janë inspektuar nga ky grup punues, është edhe hidrocentrali Morave e Binçës në Komunën e Vitisë, ku investitor ka qenë Eko Energi.

Për ta rikujtuar, po t'i listoj vetëm disa nga shkeljet të cilat janë evidentuar:

1. Dhënia e të drejtës ujore me leje ujore, e jo me koncesion, është shkelje e ligjit.
2. Pëlqimi ujqor është lëshuar në vitin 2016, ndërkaq leja ujore nuk është lëshuar fare.
3. Ndërtesa e hidrocentralit është e ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për ujërat.
4. Hidrocentrali i Binçës operon pa leje ujore, në kundërshtim me nenin 97, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 të Ligjit për ujërat e Kosovës. Si dhe një element tjetër që është shumë me rëndësi, jam edhe vetë dëshmitare pasi që vij nga ajo anë, është dëmtuar edhe flora edhe fauna dhe ka po ashtu edhe mungesë të peshqve në lumin Morava e Binçës.

Më intereson ta di, si ministër që jeni, çka keni ndërmarrë në këtë drejtim, lidhur me këtë çështje që besoj që është mjaft shqetësuese.

Ndërsa pyetja tjetër, po ashtu edhe e unë e ngre shqetësimin lidhur me rrugën Kllokot-Gjilan. E kam pasur edhe një pyetje edhe më herët lidhur me këtë çështje. Në fund të vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023 është punuar në projekte rehabilitimi, zgjerimi i rrugës N25.3 nga Kllokoti deri në Gjilan. Projekti i rrugëve regjionale lloti 2 në gjatë prej 11 km, dhe ky projekt e ka kap vlerën 4.9 milionë euro.

E dini ministër që kjo ka qenë në marrëveshje me BERZH-in, mirëpo më lejoni t'ju them dhe ta ndaj shqetësimin, po ashtu njëjtë sikurse kolegu Jahja Kokaj, punimet janë jashtëzakonisht të dobëta. Kam dalë, ia kam tërhequr vëmendjen edhe operatorit ekonomik qysh në kohën kur është bërë asfaltimi në fund të vitit 2023, mirëpo në fillim të vitit 2024, aksi, sidomos segmenti rrugor Livoç-Partesh në pjesë të Budrikës asfalti është dëmtuar jashtëzakonisht shumë.

Më intereson ta di. E di që keni kompani mbikëqyrëse që i mbikëqyrë punët, dhe në atë kam qenë në kontakt të drejtpërdrejt edhe me inxhinierin që i ka mbikëqyrë rrugët u ka dhënë vërejtje. A keni ndërmarrë diçka ndaj këtij operatori ekonomik? Lerë që i ka zvarritur punët, rruga e cila është, domethënë, ky segment rrugor ka një fluks jashtëzakonisht të madh, sepse e lidh komplet Anamoravën.

Më intereson ta di, e para, a është shkëputur kontrata, si dhe a keni marrë masa ndaj këtij operatori ekonomik?

Të paguhen 4,9 milionë euro, të jetë me BERZH-in një marrëveshje edhe tillë edhe të punohen punime kaq të dobëta, sinqerisht është shqetësuese. Unë po jua përcjell shqetësimin edhe të qytetarëve edhe të fshatit Budrikë, të cilët po ashtu kanë pasur një takim me zëvendësministrin

Hysen Durmishi, lidhur me shqetësimet e ngritura po ashtu edhe me projektin që kalon në këtë aks rrugor.

Nuk e di a i keni informacionet si të tilla të sakta, mirëpo është me rëndësi të merren parasysh edhe shqetësimet e këtyre banorëve dhe po ashtu cilësia e punimeve. Të krijohet një standard që të mos ketë punime të tilla të dobëta. Për një punë të paguhet dy herë e tri herë, e të punohet edhe të mos ofrohen shërbimet të cilat janë në shërbim të qytetarëve. E thasë edhe një herë, tash e kemi edhe mërgatën, fluksi do të jetë ende më i madh, mirëpo intereson ta di çka keni ndërmarrë për këtë operator ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: I keni dy pyetje, ministër. Urdhëro!

MINISTRI LIBURN ALIU: Për pyetjen e parë lidhur me hidrocentralin në Moravë, në Binçë. Pra, është plotësisht e vërtetë. Nga raportimi që e kemi bërë një vet një komision që e kemi shqyrtuar, jo vetëm këtë, po edhe hidrocentralet e tjera, ka dalë që ky hidrocentral për sa i përket leje ujore, ky nuk e posedon lejen ujore dhe rrjedhimisht nuk e posedon as lejen mjedisore, dhe po ashtu ndërtesa e hidrocentralit është ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për ujërat pasi që është në pronë ujore.

Hidrocentrali është i një kapaciteti të vogël që bie në kompetencën e komunës. Atë që e kemi realizuar ne, çka e realizojmë kohë pas kohe, të themi, janë që ne e dërgojmë Inspektoratin dhe urdhërojmë ndalimin e operimit, por kjo është vetëm prej pikëvështrimit mjedisor.

Për sa u përket pjesëve të tjera, është edhe në përgjegjësi të komunës, por po ashtu edhe të autoriteteve të energjisë të cilat marrin, blejnë energji nga ta.

Për sa i përket rrugës të llotit 2 Kllokot-Gjilan. Është po ashtu një rrugë e trashëguar. Vetëm dua t'ju kujtoj që në disa prej projekteve jemi detyruar t'i ndërpresim, por në disa të tjera në faza në të cilat janë ndërprerja shkakton zvarritje tepër më të mëdha, gjë që na ka sjellë edhe kokëçarje të tjera të rasti konkret i kësaj rruge.

Jemi marrë edhe unë, po në veçanti zëvendësministri Durmishi, për t'u siguruar që edhe të bëhet ndryshimi i projektit sipas kërkesave se kemi të bëjmë me ujërat atmosferike në këtë rast, e që të gjitha këto kanë marrë kohë dhe kanë sjellë telashe të vazhdueshme, gjë që jemi në fazë të përfundimit të tyre.

Sa i përket cilësisë, kemi kërkuar në mënyrë të veçantë që të vërtetohet komplet nga kompanie mbikëqyrëse cilësia e punimeve që bëhen në këtë rrugë.

KRYETARI: A keni pyetje shtesë? Jo! Vazhdojmë te deputeti Agon Batusha, e kishte pyetjen. A është Agoni këtu? Po. Zoti Batusha, pyetja është për ministrin Aliu apo jo?

AGON BATUSHA: Po. I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Unë do ta ngre çështjen e rrugës nacionale që lidh Gjakovën me Prizrenin. Duke e ditur që Gjakova ka probleme me të gjitha rrugët nacionale, e përmendem edhe më herët rrugën Gjakovë-Dollc për të cilën pajtohem me profesorin që kompania që është në hyrje të Gjakovës që po punon, është komplet joserioze.

Dhe, bindja ime është që po na sabotojnë qëllimisht. Gjithsesi, që duhet të dalim në terren ta shikojmë. Por, rruga më e ngarkuar nacionale që e lidh Gjakovën me komunat, është Gjakovë-Prizren.

Atë e frekuenton komplet Rrafshi i Dukagjinit, komplet Rahoveci dhe zona e Hasit dhe ka mungesë të theksuar të mirëmbajtje. Prandaj, zoti ministër...

KRYETARI: Qetësi, deputetë!

AGON BATUSHA: Prandaj, zoti ministër e di që edhe ju jeni duke planifikuar për rrugën Gjakovë-Prizren. Pyetja për hir të qytetarëve është se cilat janë planet e ministrisë dhe deri ku kanë arritur ato?

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI LIBURN ALIU: Të gjitha segmentet, projektet të cilat si ministri jemi duke u marrë me to, e që është një front jashtëzakonisht i gjerë i punimeve. Tash meqë jemi në realizim e sipër të rrugës së Podujevës, e cila është duke shkuar ritëm mjaft të shpejtë, të rregullt, le të themi. Kjo e Pejës, e cila po ashtu vazhdon me ritme të shpejta.

Dhe, në fazë e kemi kontraktimin e rrugës Gjilan-Bujanoc që e lidh zonën me Luginën e Preshevës atje. E radhës mbetet medoemos projekti i cili e lidh Prizrenin me Gjakovën me Deçanin, Pejën dhe Istogun, i cili është fazë të projektimit.

Pra, ne e kemi kontraktuar kompaninë për projektim. Kanë filluar ta hartojnë projektin, dhe projekti ka arritur në fazën e draftit të parë. Pra, është dorëzuar projekti ideor, i cili është duke u kontrolluar nga stafi, po flas për gjendjen momentale ku është në ministri, dhe menjëherë do të fillojmë me projektin kryesor.

Ajo çka na preokupon më tepër, paralelisht me punën e projekteve është të jemi në diskutim edhe me Ministrinë e Financave, është për mundësinë e gjetjes së financimit të këtij projekti. Definitivisht faza e parë e domosdoshme e realizimit është pjesa e segmentit nga Gjakova deri në Prizren, e pastaj të vazhdojmë edhe me faza të tjera.

Duhet ta kemi parasysh që kemi një front të gjerë të punëve. Mitrovica nga njëra anë që është duke ecur me ritme të shpejta. Podujeva, po ashtu edhe Gjakova. Dhe, këto projektet që i kemi nëpër këmbë nga e kaluar, dhe të radhës mund të themi që e kemi, por nuk mund të themi që do ta fusim në buxhet për vitin që vjen.

Sapo ta kemi realizimin e projektit, do të mundemi me Ministrinë e Financave ose të gjejmë ndonjë mekanizëm tjetër financiar që ta realizojmë këtë segment rrugor. Përndryshe, në prioritetet e Qeverisë, në radhë pas realizimit të këtyre që po themi është patjetër ky i Gjakovë-Prizrenit. Pra, me lidhjen e Gjakovës me Dollcin, me realizimin e Dollcit me Kijevën që është duke ndodhur, dhe me Gjakovë-Prizren, unë mendoj që edhe kjo zonë do të jetë e zhbllokuar nga flukset e mëdha të trafikut që është e ngarkuar deri tash.

E kemi parasysh që zonën e Xërxës, pra Gjakovë-Xërxë-Prizren është një segment tejet i ngarkuar dhe me urgjencë e kemi futur çështjen e realizimit të këtij projekti, në mënyrë që të fillojmë sa më shpejtë. Përndryshe, dua t'çju them që është një ndër prioritetet tona që duhet t'i japim rëndësi. Faleminderit për pyetjen!

KRYETARI: Pyetje shtesë?

AGON BATUSHA: Nuk e di a i ka ministri informacionet, po ka të bëjë me të njëjtën rrugë. Është veç një çështje që është ngritur shumë edhe nëpër media tek Ura Fshajtë, mburojat të cilat janë dëmtuar. E di që është me trashëgiminë kulturore çështje. Por, është afër për shkak se ka shumë ankesa se rrezikohen banorët.

KRYETARI: Ministri!

MINISTRI LIBURN ALIU: Për dallim prej situatave të mëhershme, këtë vit nuk kemi kontratë të mbikëqyrjes investive dhe për këtë çështje është dashur të fillojmë prokurim të ri. Jemi në fazë të një prokurorimi që po besoj që e realizojmë shpejtë. Po, jam i njoftuar për çështjen e Urës së Fshajtë.

KRYETARI: Deputeti Luan Ali, pyetje për ministrin e Infrastrukturës. A e kemi Luanin këto a jo? Nuk qenka këtu. Vazhdojmë tash e kemi Arbër Rexhaj. Arbër Rexhaj e ka pyetjen për ministrin Çeku. Ministrin e kemi këtu.

ARBËR REXHAJ: I nderuar ministër,

E dimë se MKRS ka ndarë buxhetin e nevojshëm për të zhvilluar punimet për përmirësimin e kushteve në stadiumin “Përparim Thaçi” në Prizren. Sigurisht se ajo që më intereson mua, por

edhe qytetarëve të Prizrenit është se, në cilën fazë është aktualisht situata në këtë projekt? Dhe, kur pritet të fillojnë punimet në stadiumin “Përparim Thaçi”? Këtu edhe e ke pyetjen shtesë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zoti deputet,

Në fund të vitit 2022, komuna na ka njoftuar që e ka shkëputur kontratën me operatorin që ka qenë duke i zhvilluar punimet në stadiumin “Përparim Thaçi”.

Ne gjithmonë e kemi pasur kodin e veçantë buxhetor për këtë stadium në mbështetje të realizimit të punimeve. Nga koha e shkëputjes së kontratës, komuna nuk e ka bërë asnjë lëvizje në drejtim të përfundimit të pjesës së mbetur të punimeve.

Për këtë arsye ne jemi detyruar që ta marrim përsipër gjithë procesin. Aktualisht e kemi kontraktuar studion e projektimit e cila po e bën projektimin e fazës së fundit të punimeve, dhe në momentin që na dorëzohet projekti përfundimtar i stadiumit, ne i nisim procedurat për ta përfunduar stadiumin dhe për ta sjellë në kategorinë 2, sipas standardeve ndërkombëtare të UEFA-s. Faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë zoti Rexhaj? Jo! Vazhdojmë. Milazim Salijaj, pyetje për ministrin Aliu. Interesimi më i madh i mazhorancës është për infrastrukturën siç duket.

MILAZIM SALIJAJ: Pa infrastrukturë s’ka. Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Çështja që dua të adresojë ka të bëjë me ndërtimin mbi lumin Lepenc për banorët e fshatrave Nikaj, Biçec, Kovaçec dhe Rekë të Komunës së Kaçanikut.

Me rastin e prezantimit të Projekt-buxhetit për vitin 2024 nga ana e ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, zotëri Liburn Aliu, më datë 15.10.2023 dhe të nesërmen më datë 16.10.2023 nga ana e zëvendësministrit Hysen Durmishi, në atë takim kemi kërkuar që në Projekt-buxhetin e vitit 2024 të parashihet ndërtimi i kësaj ure për mbi 5 mijë banorët e këtyre fshatrave dhe të fshatrave që e frekuentojnë këtë lokacion dhe këtë urë.

Përgjigjja e zëvendësministrit ishte se për urën që ju po kërkonit të ndërtohet, duhet ta sillni projektin detaj të urës. Me përgjigjen, të cilën u pajtuam edhe ne, ngase pa projekt-detaj të urës, ura nuk mund të ndërtohej. Të nesërmen, më 17. 10. 2023, ashtu siç ishim dakorduar me zëvendësministrin, e kam dërguar në zyrën e tij projektin detaj të urës me kërkesën për ndërtimin e kësaj ure të parashihet në Projekt-buxhetin e vitit 2023.

Duke u nisur nga kjo që u elaborua, pyetja për juve i nderuar ministër Aliu, është: a pritet të fillojë ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc për banorët e fshatrave Nikaj, Biçec, Kovaçec, Rekë dhe të fshatrave që e frekuentojnë këtë lokacion dhe këtë urë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministri Aliu!

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet, për sa i përket ndërtimit të urës mbi lumin Lepenc, dua t'ju njoftoj që kjo rrugë dhe urë nuk është në kompetencën e ministrisë, mirëpo jemi duke shikuar mundësinë që në buxhetin për vitin që vjen ta përfshimë në buxhet projektin e realizimit të kësaj ure në lumin Lepenc.

KRYETARI: Pyetje shtesë? Nuk ka pyetje shtesë. Tash Mirlinda Tishukaj-Sadiku e kishte pyetjen për ministren Rizvanolli, por ministren nuk e kemi këtu. Mirlinda, më duket pyetjen për ministrin Aliu e bërë tashmë a? Atëherë, shkojmë te Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministren Haxhiu, të cilën nuk e kemi këtu.

E kemi edhe pyetjen 69 deputetit Salijaj. Edhe një pyetje tjetër e paske për ministrin Aliu. Urdhëro! Dhe, me këtë po e përfundojmë.

MILAZIM SALIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Çështja që dua të shtroj ka të bëjë me ndërtimin e dy mbikalimeve në qytetin e Kaçanikut, aty ku po zhvillohen punimet në projektin e rehalibimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit.

Me qëllim të lëvizje së lirë të qytetarëve dhe të nxënësve të dyja shkollave, gjimnazi “Skënderbeu” dhe shkollës fillore të mesme të ulët “Emin Duraku” me paralelen e ndarë në Dushkajë si dhe të revitimit të ndarjes së qytetit dhe pas shqetësimeve edhe të qytetarëve, vitin e kaluar u jemi drejtuar me pyetje parlamentare për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të sa paku dy mbikalimeve për këmbësorë në afërsi të gjimnazit dhe stacionit hekurudhor, dhe përgjigja juaj në lidhje me shqetësimet e qytetarëve të Kaçanikut ishte se do të fillohet me projektimet e këtyre mbikalimeve dhe posa projektet të jenë gati, do të bëhet edhe tenderimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik në kryerjen e punëve në ndërtimin e këtyre mbikalimeve.

Nënkalimi dhe dy mbikalimet janë domosdoshmëri për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe nxënësve që i frekuentojnë dy shkollat e lartpërmendura dhe do ta shmangin ndarjen përfundimtare të qytetit të Kaçanikut.

Duke u nisur nga kjo që u elaborua, pyetja për juve i nderuar ministër, është: deri ku është arritur me projektimin e këtyre mbikalimeve dhe a do të fillojë brenda këtij viti ndërtimi i këtyre mbikalimeve si kërkesë dhe domosdoshmëri për qytetarët e Kaçanikut? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministri Aliu, urdhëroni!

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet, faleminderit!

Për sa i përket ndërtimit të dy mbikalimeve, ne jemi në fazën e projektimit të tyre.

Pra, projektimi ideor ka përfunduar dhe tash po e fillojmë fazën e projektit zbatues të këtyre dy mbikalimeve. Menjëherë sapo ta mbarojmë projektin zbatues, fillojmë me procedurën e mëtejme për realizimin e tyre.

KRYETARI: Pyetja 66 është deputetit e Nijazi Isaku, dhe kjo është pyetja e fundit siç duket sa u përket deputetëve të pranishë.

NIJAZI ISAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Në muajin gusht të vitit të kaluar pati filluar punimet në kyçjen e autostradës “Arbër Xhaferri” në Gërllicë. Dhe, deri tani, e dini edhe me projekt, ka qenë 175 ditë përfundimi i tyre.

Çka po ndodh me atë kyçje? Me të vërtetë qytetarët janë të shqetësuar dhe po e ngrisin vazhdimisht te ne si deputetë, çka po ndodh me kyçjen. Për arsye se realisht do të duhej të përfundonte tani kur po diskutojmë, kyçjen.

E dimë aty, se kalojmë shumë shpesh, e dimë që shumë pak punime janë kryer aty. Çka ka ndodhur nëse mundesh për neve dhe qytetarë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Aliu e ka fjalën.

MINISTRI LIBURN ALIU: Punët janë ndërprerë përkohësisht si rezultat i nevojës së ndryshimeve të projektit.

Besoj që për këto çështje të ndryshmeve të projektit që kanë qenë të pashmangshme, besoj që jeni njoftuar dhe jemi në përfundim të kësaj dhe sapo ta përfundojmë, menjëherë do të rifillojmë. Është një situatë e paparashikueshme që na ka dalë.

KRYETARI: Pyetje shtesë? Urdhëro!

NIJAZI ISAKU: Faleminderit, kryetar!

Ju kuptoj ministër, se edhe në projektimin kur është bërë. Ne e dimë që një kompani që e ka bërë projektimin për atë kyçje ka pasur kontratë për tri vjet për projektim. Do të thotë, që edhe atë projektim ka qenë pikërisht kompania e një pronari që është pjesë e LDK-së, e financon LDK-në.

Dhe, në atë kohë unë kam hezitur që do të ketë kësi problemi pastaj që do të na dalin në rrugë që s'e ka bërë edhe projektimin mirë. Edhe po del që këto pengesa që po dalin në projektim, tash po zvarriten punët veç të na nxjerrin sa më keq para qytetarëve të Komunës së Vitisë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI LIBURN ALIU: Ka mundësi që mund të jetë ashtu. Definitivisht komplet sistemi qoftë i projektimit, qoftë i kontrollit të cilësisë, qoftë i zbatimit të punëve edhe kontrollit të cilësisë në zbatim, është tash ende larg nga ajo që do të duhej të ishte.

Por, pakrahasimisht që më mirë se që ka qenë dikur. Unë dua të them që një pjesë të madhe të projekteve që i kemi trashëguar janë projekte të punuara dobët. Sot ka kontroll më të madhe të cilësisë në projektim, ama telashet e tilla do të vazhdojnë të na ndjekin edhe një kohë.

Shembulli i rrugës së Gjilanit dhe shembulli i rrugës së Gjakovës janë dy shenja të cilat tregojnë që situata e nivelit të projektimit dhe të analizave të elaborateve të shpronësimit pa e shqyrtuar mirë situatën faktike në terren, ka qenë problem themelor i ministrisë.

Kjo është mbase telashi kryesor që ne kemi. Dhe, interesimi ynë para se të sigurohemi se apo fillojmë me projekte të reja, ka qenë a po mund ta ndërtojmë një sistem më të suksesshëm, më efikas të projektimit dhe të mbikëqyrjes.

Po besoj që jemi në rrugë të mirë. Kjo është.

KRYETARI: Pyetje tjetër? Jemi 53 deputetë të pranishëm, kështu që marrim pauzë deri në orën 13:30. Kthehemi në orën 13:30. Gjysmë ore pauzë dhe vazhdojmë. Jo, jo. Pushimin e marrim prej orës 15:00. Kjo është vetëm një pauzë për shkak që nuk jeni të pranishëm.

* * *

E enjte, më 11 korrik 2024

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 qershor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Tash e kemi vazhdimin e seancës, e filluar më 27 qershor 2024.

Urdhëro, z. Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e propozoj një mocion përmbajtjesor, mocion i cili kërkon ndryshimin e rendit të ditës së kësaj seance.

Pra, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkojmë që përmes një rezolute ta obligojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës për tërheqjen e tri projektligjeve, të cilat ne vlerësojmë që janë në kundërshtim me frymën kushtetuese. Pra, procedimi sot i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, procedimi i Ligjit për Këshillin e Pavarur për Media dhe procedimi i Ligjit për shërbyesit civilë, janë tri projektligje që janë në kundërshtim me frymën kushtetuese në vendin tonë.

Ne si opozitë nuk duam që thjesht ta kemi një betejë politike në këto tri projektligje. Mendoj që mund të punojmë së bashku, sidomos në ligjin i cili e cenon fjalën e lirë dhe mediat e lira në vendin tonë. Konsiderojmë që një angazhim yni i përbashkët mund ta nxjerrë vendin prej kësaj situatë.

Ju i keni parë në vazhdimësi edhe asociacionet ndërkombëtare të mediave dhe shoqërisë civile që kanë akuzuar në vazhdimësi për cenimin e fjalës së lirë përmes këtij projektligji. Prandaj, ju e dini që seancën e kaluar nuk ka pasur votë të mjaftueshme që këto tri projektligje të tërhiqen, andaj sot e shfrytëzojmë të drejtën tonë si opozitë që përmes kësaj rezolute, ta obligojmë Qeverinë që këto tri ligje të tërhiqen. Në mënyrë që të punojmë së bashku si pozitë e opozitë dhe pastaj të vazhdojmë që t'i sjellim Kuvendit tri projektligje, të cilat nuk do të jenë në kundërshtim me Kushtetutën kështu siç janë sot.

Për përmbajtjen e tyre do të flasim në rast se ky mocion do të ketë sukses, pra do të jetë pjesë e rendit të ditës.

Ne propozojmë që ky mocion të jetë pikë e parë në këtë seancë, pra të fillojmë me këtë pikë, pastaj të shkojmë me vazhdimin e seancës. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat mocionin. A kanë nevojë të deklarohen kryetarët, apo të shkojmë drejt në votim.

Fjalën po kërkon z. Gashi? Urdhëro, z. Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike vlerëson se mocioni është i arsyeshëm dhe këto tri ligje kanë përmbajtje të theksuar kundërkushtetuese dhe si të tilla duhet të tërhiqen nga rendi i ditës dhe Kuvendi të mos i shqyrtojë. Pra, bëhet fjalë për Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Projektligjin për zyrtarët publikë.

Të tri këto projektligje kanë përmbajtje të thellë antikushtetuese dhe rekomandojmë që të mos shqyrtohen në lexim të dytë nga Kuvendi, sepse do të ishin në vazhden e problematikave që kjo Qeveri me projektligjet që ka propozuar, i ka shkaktuar Republikës së Kosovës.

Pra, do të ishin tri projektligjet e radhës, të cilat do të ishin me përmbajtje të theksuar antikushtetuese dhe si Kuvend i Republikës së Kosovës nuk duhet të lejojmë që diçka e tillë të ndodhë nën përkuqdesjen tonë dhe me vetëdijen tonë.

Për çështje të tjera, pastaj do të flasim pastaj, por këto janë me përmbajtje të thellë antikushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën ia japim kryetarit të Grupit të AAK-së, Besnik Tahirit.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si opozitë mendojmë që kjo mund të jetë një ndër seancat më të dëmshme të kësaj legjislature, për shkak se kjo seancë, siç po shihet, ka mundësi t'i miratojë tri ligje, të cilat në esencë e kanë veç një synim: kapjen e shtetit në mënyrë ligjore, kapjen e institucioneve të pavarura, të cilat mbikëqyren nga bordet respektive dhe të cilat do të krijojnë dëme afatgjate.

Duhet t'ju them vetëm dy çështje, të cilat mendoj janë të vlefshme për ju t'i kuptoni, respektivisht qytetarët e Kosovës.

Në qoftë se e kaloni Ligjin për administratë shtetërore, mos harroni, nuk do të ketë më Qeveri që do të mund ta ndryshojë. 1 900 pozita jeni duke ua dhënë partive politike dhe koalicioneve që do të udhëheqin Qeverinë. Qeverisni ju prapë, mirëpo kurrë më s'do të mund të ndryshohet. 1900 pozita të nivelit të mesëm e të lartë po ia jepni vendimit të një komisioni që do ta vendosë dhe në

të njëjtën kohë po e legjitimoni me ligj ushtruesin e detyrës si funksion dyvjeçar. Pra, me një e-mail bëhet ushtrues i detyrës një sekretar i përgjithshëm, me një e-mail shkarkohet.

Jeni duke e bërë me ligj, veç dijeni! Dijeni çka jeni duke votuar, të nderuar kolegë!

Çështja e dytë, te Këshilli Prokurorial i Kosovës pse po kërkojmë të hiqet. Një herë keni kërkuar të shtoni tetë deputetë më shumë. Në rregull, mirë shumë. Tash, po doni ta ktheni në shtatë anëtarë. Prej këtyre shtatë anëtarëve, po doni tre të jenë joprokurorë, që kanë funksione publike, drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, anëtari i komuniteteve në Komitetin konsultativ dhe drejtorin a Ombudspersonin.

Kush i zgjedh këta deputetë? Kush janë deputetët? Përfaqësues të partive politike. A po hyjnë njerëz joprokurorë në Këshilli Prokurorial, si njerëz që votohen përmes matematikave? Ju e dini vetë, keni ardhur edhe e keni emëruar një person në Këshilli Prokurorial të Kosovës, pas dy ore keni thënë jo qenka politik. Pra, mos harroni çka jeni duke bërë. Po e bëni dëmin e dytë duke e prekur këtë institucion.

E fundit, te mediat. Kemi punuar shumë në atë komision. Thënë të drejtën, e them që kryetari i komisionit, z. Ramadani, ka bërë një angazhim shumë të madh. Mirëpo, në fund, prapë ky ligj është duke e dëmtuar dhe ka ankesa jo vetëm nga ne si opozitë, po nga të gjitha instancat ndërkombëtare.

Kërkesa ime është: mos e votoni, për shkak se do ta merrni etiketën që ia keni bërë një dëm afatgjatë Kosovës, e që pastaj asnjë koalicion a parti nuk do t'i heqë këto ligje, se ka interes t'i mbajë këto institucione. Faleminderit!

KRYETARI: Adnan Rrustemi, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati i njëjtë u zhvillua pothuajse edhe në seancën e kaluar. Duhet ta kemi një gjë parasysh. Ishte mocion procedural në një seancë me vazhdime nga seanca e kaluar, ku pritet pa dyshim të shqyrtohen dhe të votohen një mori projektligjesh në lexim të dytë, shumë të rëndësishme pa dyshim për qytetarin dhe republikën.

Janë tri projektligje të ndryshme për nga natyra, megjithatë po propozohet mocioni në mënyrë të themi kumulative. Duhet ta themi një gjë, nuk mund t'i kërkohej sponsorizuesit nëpërmjet rezolutës tërheqjen e këtyre projektligjeve nga rendi i ditës, paçka se ne si grup parlamentar jemi

kundër dhe pa dyshim qëndrojmë prapa qoftë propozimeve nga Qeveria, qoftë amendamenteve që janë bërë nga ana e komisioneve funksionale.

Duhet ta themi një gjë, të tri projektligjet kanë ndjekur secilën procedurë në kuptimin e dëgjimeve publike, diskutimit me palët e interesit dhe secili deputet e ka pasur mundësinë të bëjë propozime, vërejtje dhe sugjerime.

Është e pashembullt se si deputetët e opozitës nuk japin asnjë kontribut në procedurat mes dy leximeve, nuk bëjnë asnjë vërejtje, nuk bëjnë asnjë kundërshtim, për të mos thënë, nuk bëjnë asnjë propozim.

Ndërkohë, vijnë në seancë në plenare nëpërmjet një mocioni në mënyrë të përmbledhur kërkojnë tri projektligje të tërhiqen nga rendi i ditës.

Të tri këto projektligje, jemi të bindur që përmbushin standardet më të mira ndërkombëtare, janë përgjigje ndaj fenomeneve shqetësuese në Kosovë. Ne i ftojme deputetët të ecim tutje me shqyrtimin dhe miratimin e tyre.

KRYETARI: Sa deputetë jemi, ju lutem?

77 deputetë. Përgatituni për votim!

Kush e mbështet këtë mocion?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

21 deputetë e mbështetën mocionin, 53 ishin kundër dhe 1 deputet abstenoi.

Kështu që nuk kalon ky mocion.

E keni edhe një mocion tjetër, z. Tahiri, urdhëro!

Blerta Deliu-Kodra e bën prezantimin e mocionit.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Partia Demokratike e Kosovës sot propozon një mocion për plotësimin e rendit të ditës së kësaj seance parlamentare.

Propozojmë që pika në vijim të jetë pikë e parë e rendit të ditës për diskutim, ndërkohë që do ta bëj edhe arsyetimin e kësaj çështjeje, të cilën po e propozojmë si Parti Demokratike e Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Pra, nuk mund të jemi indiferentë që brenda tre muajve janë arratisur tre persona të cilët kanë qenë të dënuar për vrasje. I dënuari i fundit i cili është arratisur ishte Mark Oroshiq, i cili ishte një ndër katër të dënuarit për vrasjen e politikanit serb nga Kosova, Oliver Ivanoviq.

Ndërkohë që javën e kaluar, Faton Hajrizi, i dënuar me 27 vjet burgim për vrasjen e një ushtari rus, u arratis nga dhoma e burgut përmes dritares.

Gjatë muajit maj u arratis edhe Enver Sekiraqa i dënuar me 25 vjet burgim nga Gjykata Themelore e Prishtinës për nxitjen e vrasjen e ish-policit Triumf Riza.

Të nderuar kolegë deputetë,

Deri më tani asnjë përgjegjësi ligjore a morale nga persona zyrtarë që udhëheqin institucionet kompetente të sigurisë. Ky dështim në të njëjtën kohë paraqet edhe degradimin e plotë të këtyre institucioneve, gjendje në të cilën Kuvendi nuk mund të qëndrojë indiferent.

Prandaj, përballë këtyre detyrimeve kushtetuese dhe mbikëqyrjes së punës sonë si deputetë, propozoj që si pikë e parë e rendit të ditës të trajtohet çështja e paraqitur pak më herët, d.t.th. që ka për qëllim arratisjen e tre personave të cilët janë të dënuar për vrasje.

Konsideroj që kolegët deputetë do ta japin votën e tyre, në mënyrë që ta trajtojmë këtë çështje si pikën e parë të rendit të ditës.

KRYETARI: Grupet parlamentare.

PDK-ja e mbështet automatikisht.

Sa i përket LDK-së, z. Gashi, kryetar i grupit. Urdhëroni z. Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Vlerësoj se është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe që Kuvendi i Republikës së Kosovës të debatojë lidhur me arratisjen e personave të dënuar apo në procese gjyqësore.

Mbi të gjitha, duhet të diskutohet edhe për disa çështje që janë shumë delikate. Sa ka qenë e përfshirë Ministria e Drejtësisë në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës? Këto plotësime-ndryshime a kanë ndikuar në nenet 184, 185, 186, 187, 188 dhe 189 të Kodit të Procedurës

Penale dhe këto ndryshime a kanë ndikuar në lirimet nga burgjet që kanë ndodhur, sidomos në lirimin e rastit Sekiraqa.

Pra, duhet ta debatojmë këtë çështje me Ministrinë dhe ministren e Drejtësisë konkretisht, po edhe me Qeverinë në përgjithësi, për të parë implikimet dhe cilat kanë qenë arsyet e plotësim-ndryshimeve që kanë ndodhur në vitin 2022. A kanë ndikuar këto plotësim-ndryshime në lehtësimin e masave të personave nën masën e sigurisë, arrest me burg apo arrest shtëpiak.

Po ashtu, është me rëndësi që të diskutohet dhe të debatohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës se cili është roli i personave politikë të emëruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe transferimet nëpër burgje dhe masat të cilat janë marrë për dërgimin e personave të caktuar nga burgjet e sigurisë më të lartë në burgje të sigurisë më të ulët dhe pastaj arratisja e këtyre personave të dënuar për vepra të rënda penale.

Po ashtu, duhet të debatojë ky Kuvend i Republikës së Kosovës si mund të jetë në arrest shtëpiak një person i dyshuar për vrasje të rëndë? Pra, këto janë elemente jashtëzakonisht të rëndësishme të karakterit urgjent dhe ky Kuvend duhet patjetër t'i diskutojë. Ne e përkrahim këtë mocion përmbajtjesor. Faleminderit!

KRYETARI: Ishte qëndrimi i Lidhjes Demokratike. Tash, AAK-ja. Bekë Berisha flet.

BEKË BERISHA: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryetar,

Edhe ne si parti, po edhe si deputetë e përkrahim kërkesën që të debatohet për këtë çështje që është shumë sensitive.

Këtu është në pyetje autoriteti i shtetit. Nëse ikin të burgosurit për çdo ditë dhe kjo kalon në normalitet, atëherë po shihet që këtu kemi probleme të mëdha.

Unë jam që të debatojmë, megjithëqë në këto kushte që nuk po dëgjohet asgjë, është problem edhe të diskutohet. Po shpresoj që të kalojmë në sallën tjetër, edhe atje mund të dëgjohemi besoj. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, sa jemi tash?

82 deputetë janë të pranishëm.

Përgatituni për votim!

Kush e mbështet mocionin, i cili u propozua nga deputetja Blerta Deliu-Kodra?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

26 deputetë e mbështetën mocionin, kundër ishin 53 deputetë, 2 deputetë abstenuan.

Nuk kalon mocioni, kështu që kalojmë drejtpërdrejt në vazhdimin që e kemi caktuar më herët.

Ju lus të uleni dhe ju lus për qetësi!

Të nderuar deputetë, e kemi tash pikën:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Do t'i hedh në votim tash. Faktikisht, do t'ju pyes nëse ka vërejtje. Nëse s'ka vërejtje, e këqyrim a kemi kuorum. Automatikisht konsiderohet i votuar procesverbali.

Po ju pyes për procesverbalet e këtyre seancave: seancën e 4 prilli, si dhe seancën e 2, 16 dhe atë të 23 majit.

Uluni!

E shohim a kemi kuorum. 62 deputetë jemi.

A keni vërejtje në procesverbalet e këtyre seancave, të cilat i kemi mbajtur?

Nëse nuk ka, atëherë konstatoj që procesverbalet e këtyre seancave miratohen.

Pikën e parë e kemi një marrëveshje ndërkombëtare. Nuk i kemi kushtet për t'u votuar ajo, sepse nevojiten 80 vota, 80 deputetë të pranishëm së paku. Është ajo e financimit të Programit të parë për politikën zhvillimore të efektivitetit fiskal, është e lidhur mes Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Nuk i kemi mundësitë.

Prandaj, vazhdojmë drejt e në pikën e pestë:

5. Votimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë

Diskutimet kanë përfunduar, nëse po ju kujtohet, për këtë pikë. Të gjitha debatet janë shterur, kështu që shohim se a po kalon ky Statut. 62 deputetë janë prezentë.

Të nderuar deputetë,

Kush e mbështet statutin në fjalë?

Kush është kundër këtij statuti?

Kush abstenon për këtë statut?

Më thonë që rezultati ishte ky: 57 ishin për, kundër ishin 2 deputetë, abstenim ishin 2 dhe 1 deputet nuk votoi fare.

Kështu që, me 61 deputetë që kanë marrë pjesë në votim, konstatoj që kalon Statuti i Universitetit të Prishtinës.

Jemi tash te pika e radhës:

6. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor

Nuk e kemi Visar Korenicën këtu, deputetin, siç duket. Dhe, ai do të duhej t'i paraqiste këto amendamente të cilat shumica, së paku gjysma janë të deputetit Korenica. Zoti Eman Rrahmani e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti i parë është propozuar, është diskutuar prej deputetit Visar Korenica, kurse amendamentet e tjera jam i autorizuar unë që për shkak që janë bashkërisht të propozuar, në qoftë se ky kalon, amendamentet e tjera propozohen nga unë.

KRYETARI: Me sa po më kujtohet, dhe këtë e konfirmoi më duket edhe zoti Rrahmani, amendamenti 5, më duket ka arritur ta prezantojë zoti Korenica, më sa më kujtohet. Atëherë, për këtë do t'ia japim epilogun vetëm përmes votimit.

Sa deputetë jemi? 61 qenkemi.

Përgatituni për votim, të nderuar deputetë! Po flasim për amendamentin 5 të propozuar nga deputeti Visar Korenica.

Kush e mbështet këtë amendament?

Kush është kundër amendamentit?

Kush abstenon?

Vetëm 43 deputetë kanë marrë pjesë në votim. As për se afërmi nuk jemi numrit të nevojshëm që të miratohet ky amendament.

Kështu që, pa u zgjidhur kjo nuk kemi se si të procedojmë me këtë pikë. Dalim te pika tjetër.

Ashtu si marrëveshja ndërkombëtare, edhe kjo i kalon një seance të cilën e organizojmë në vazhdim.

7. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Ka mbetur vetëm çështja e votimit. Më duket që 61 jemi ende a po. E kemi kuorumin. E hedhim në votim këtë projektligjin për gjendjen civile.

Kush e mbështet këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Vetëm 47 deputetë morën pjesë në votim. As për këtë projektligj nuk kemi kuorum. Ky i kalon një seance të re, kurdo që e organizojmë.

Tash e kemi:

8. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar. A jemi 61? E hedhim në votim.

Kush e mbështet Projektligjin për provimin e maturës shtetërore?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Vetëm 58 deputetë kanë votuar. Nuk është e mjaftueshme. Nuk kemi kuorum për këtë projektligj. Edhe ky i kalon një seance të re.

Pika e radhës, të nderuar deputetë, është:

9. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-296 për të huajt

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e 23 majit. Tash pritët vetëm votimi. A jemi ende brenda kuorunit?

Të nderuar deputetë,

Kush është për Projektligjin për të huajt?

Kush është kundër këtij projektligji?

Kush abstenon?

61 deputetë, të gjithë e votuan Projektligjin për të huajt, kështu që konstatoj që miratohet në parim ky projektligj.

I kërkojmë si gjithmonë Komisionit FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme ta trajtojnë atë, pastaj të na e sjellin sipas afateve raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë,

Tash e kemi një projektligj tjetër, është ai për sportin. Është lexim i dytë, është shqyrtim i dytë i projektligjit.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-277 për sport

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL për Arsim, ku hyn edhe sporti, e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe na e ka rekomanduar miratimin e tij së bashku me amendamentet e propozuara këtu.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban kosto buxhetore shtesë, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kurse amendamentet të cilat janë propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Komisioni për Integritim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk e cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e këtyre komuniteteve.

Po ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Arsim. Deputeti Ardian Gola e paraqet dhe e arsyeton raportin para Kuvendit.

ARDIAN GOLLA: I nderuar kryetar,

Komisioni për Arsim e ka trajtuar sipas kërkesave procedurale edhe Projektligjin për sport. I ka realizuar të gjitha dëgjimet publike. Janë bërë numër amendamentesh, dhe u është dërguar po ashtu komisioneve të përhershme. Nuk ka impakt të papërballueshëm buxhetor. Nuk bie ndesh as me të drejtat e komuniteteve as me ‘acquis communautaire’ dhe nuk bie ndesh me kornizën ligjore të përgjithshme të Kosovës.

Andaj, i lusim deputetët e pranishëm që të votojnë për këtë projektligj, ashtu që të kemi një nismë, një taban fillestar që është shumë me rëndësi për të mbajtur edhe Lojërat Mesdhetare që pritet të mbahen në Kosovë. Është projektligj me shumë rëndësi, andaj do t’ju lusja që ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Gola edhe për një sqarim shtesë!

ARDIAN GOLA: Të nderuar deputetë, edhe një sqarim shtesë. Është përvjedhur një gabim teknik, i cili megjithatë duhet të adresohet përmes nenit 78 të Rregullores, paragrafi 2. Andaj, me mirëkuptimin tuaj, do të donim që të tërhiqemi si komision, vetëm të rregullojmë këtë gabim teknik që nuk është substancial, por megjithatë mund të çojë peshë në implikimet juridike.

Prandaj, do t'ju lusja që si komision të tërhiqemi me lejen e seancës dhe ta rikthejmë prapë për votim përfundimtar.

Faleminderit!

KRYETARI: E trajtomë edhe Ligjin për falimentim, por duhet t'i trajtojmë secilin veç e veç. Kështu që e hedhim në votim këtë kërkesë të kryetari të komisionit, Gola.

I ftojme të gjithë deputetët që të kthehen, ata që janë në korridor eventualisht. A e kemi kuorumin, ju lutem?!

61 deputetë janë prezentë. E votojmë këtë kërkesë të zotit Gola që t'i kthehet ky projektligj komisionit për t'i shmangur klauzolat që janë në kolizion. Ndryshimet teknike. Bëhet shpejt kjo nëse komisioni mblidhet. E hedhim në votim.

Është Projektligji për sportin.

Kush është për këtë propozim?

Kush është kundër këtij propozimi që projektligji t'i kthehet komisionit edhe një herë?

Kush abstenon?

Të gjithë e mbështetën këtë propozim, kështu që... Kjo i referohet Rregullores, nenit 78.

Komisioni duhet të paraqesë raport plotësues gjatë zhvillimit të seancës kur të trajtohet kjo pikë. Menjëherë pasi të kryhet trajtimi nga ana e komisionit. E përfunduar edhe këtë çështje.

Tash zoti Rrustemi ma ka kërkuar fjalën që e njëjta procedurë të ndodhë edhe për një projektligj tjetër. Ia japim fjalën dhe e shohim se për cilin projektligj e ka fjalën.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Për ta racionalizuar kohën. Edhe ne kemi një kërkesë të njëjtë sikurse Komisionin për Arsim, për Projektligjin për falimentim. Për të shmangur kolizionin e referencave teknike të ky projektligj, kërkojmë që seanca ta mundësojë ta kthehemi në mbledhje të komisionit dhe të sjellim raport plotësues brenda seancës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Është e njëjta procedurë, vetëm për një ligj tjetër që t'i kthehet komisionit, ta trajtojnë shpejt, pastaj t'i kthehemi seancës me këto vazhdimet. Edhe një projektligj tjetër, mirëpo

e votojmë një herë propozimin e zotit Rrustemi që projektligji t'i kthehet për një raport plotësues edhe për një shqyrtim shtesë komisionit.

A e kemi kuorumin?

Kush e mbështet propozimin e zotit Rrustemi?

Kush është kundër? 2 vota kundër.

Kush abstenon?

58 deputetë e mbështetën këtë kërkesë. 2 deputetë ishin kundër dhe 1 deputet abstenoi. Kështu që, kalon ky propozim i zotit Rrustemi.

Edhe një propozim tjetër e ka...

Atëherë, po pajtohemi që ta hedhim kur t'i vijë rendi, kështu që të dyja komisionet kanë nevojë të mblidhen apo jo? Që t'i trajtojnë ato dy projektligje. Sa po marrim pushim deri kur të kthehen?

Është e domosdoshme, se këta duhet të shkojnë, të mblidhen dhe t'i trajtojnë ato. Është e pamundshme! Nuk e kemi kuorumin pa këta, se jemi 61. Mirë! 20 minuta, besoj që e kryen punën. 15 ose 20 minuta. Mirë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Tani jemi 61 deputetë. Mund të vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL për Arsim, me qëllim qartësimi dhe evitimit të gabimeve teknike, në mes të paragrafëve 1 dhe 2, si dhe paragrafit 4 në amendamentin 31, në raportin me rekomandime për këtë projektligj ka paraqitur raportin plotësues për ndryshimin e amendamentit 31.

Prandaj, pasi kemi kaluar nëpër procedurë, kushtet janë të gatshme që të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL.

Zini vendet tuaja, ju lutem!

Amendamenti i parë i ka dy propozime: Versioni i Komisionit FunkSIONAL dhe ai i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu. Ne e hedhim në votim amendamentin e Komisionit FunkSIONAL, versionin e Komisionit FunkSIONAL.

Shikojmë se sa deputetë janë të pranishëm? 61.

Të nderuar deputetë,

Kush është për amendamentin e Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët, 61, kanë votuar për versionin e Komisionit FunkSIONAL të amendamentit të parë, kështu që kalon ai.

Amendamenti i dytë është i Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin e dytë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 deputetë e mbështetën. Kalon amendamenti i dytë.

Amendamenti i tretë, Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin e Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Zoti Kervan dhe disa deputetë të tjerë nuk kanë votuar. A ka mundësi...? Ka votuar, po thotë.

(Ndërprerje e incizimit)

59 deputetë ishin kundër, dy vota abstenuese, rrëzohet amendamenti 3 i Bekim Haxhiut.

Amendamenti 4, po ashtu i zotit Haxhiu.

Kush e mbështet amendamentin 4 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

59 deputetë kundër amendamentit të Bekim Haxhiut, dy abstenime, rrëzohet amendamenti 4.

Amendamenti 5 i ka dy propozime, të Komisionit FunkSIONAL dhe të Bekim Haxhiut.

Ne e hedhim në votim atë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për amendamentin 5 të Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 deputetë në favor të amendamentit 5 të Komisionit FunkSIONAL, kalon ai.

Amendamenti 6 është i Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin 6 të Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 e mbështetën e mbështetën amendamentin 6 të Komisionit FunkSIONAL. Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7 është i Bekim Haxhiut, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin 7 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Rezultati është ky: E mbështeti këtë amendament vetëm një deputet, 58 kundër, 2 abstenime. Nuk kalon amendamenti 7 i Bekim Haxhiut.

Amendamenti 8, po ashtu i Bekim Haxhiut.

Kush e mbështet amendamentin 8 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Rezultati i njëjtë më duket, 1 votë për, 58 kundër, 2 abstenime.

Nuk kalon amendamenti 8 i Bekim Haxhiut.

Amendamenti 9 nga Komisioni FunkSIONAL.

Kush është për këtë amendament?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 vota për amendamentin 9 të Komisionit FunkSIONAL.

Kalon.

Amendamenti 10 i Bekim Haxhiut, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin 10 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Pra, e kemi këtë strukturë që po përsëritet, 1 votë për, kundër 58, 2 abstenime.

Bie poshtë amendamenti 10 i Bekim Haxhiut.

Amendamenti 11 i Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin e Komisionit FunkSIONAL, 11?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 vota, në përkrahje të amendamentit 11.

Kalon.

Amendamenti 12 me dy propozime, Komisioni FunkSIONAL dhe Bekim Haxhiu, versioni i dytë.

E hedhim atë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet versionin e Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 12, versioni i Komisionit Funksional.

Amendamenti 13, po ashtu e ka të njëjtën strukturë, versioni i Komisionit Funksional dhe ai i Bekim Haxhiut.

Ne e hedhim në votim atë të Komisionit Funksional.

Kush është për këtë amendamentin 13 të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 vota i mori propozimi i Komisionit Funksional në amendamentin e 13-të. Kalon.

Amendamentet 14, 15 dhe 16. I hedhim në pako, të gjitha janë të Komisionit Funksional. Kur po janë dy versione, nuk po kemi mundësi t'i votojmë në pako.

I hedhim këto tri amendamente të Komisionit Funksional.

Kush është për këto tri amendamente të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët votuan për amendamentet 14, 15 dhe 16, të gjitha të Komisionit Funksional. Miratohen.

Amendamenti 17 i ka dy propozime: të Komisionit Funksional dhe të Bekim Haxhiu. Ne e hedhim të Komisionit Funksional së pari.

Kush është për amendamentin 17 të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon.

Të gjithë, 61 deputetë, e mbështetën këtë version të Komisionit Funksional. Kalon.

Tash i votojmë amendamentet 18, 19 dhe 20.

Këto tri amendamente janë të Komisionit Funksional. Nuk ka version tjetër të paraqitur, kështu që i votojmë ato.

Kush është për këto tri amendamente të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

U miratuan me 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, amendamentet 18, 19 dhe 20.

Tash vijmë te amendamenti 21, ky është i Bekim Haxhiut.

Kush e mbështet amendamentin 21 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

59 kundër, për asnjë votë, dy abstenime, rrëzohet amendamenti 21.

Tash do t'i votojmë tri amendamente: amendamentet 22, 23 dhe 24. Të tria janë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush i mbështet këto tri amendamente të Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 deputetë, i votuan amendamentet 22, 23 dhe 24.

Amendamenti 25 i ka dy propozime: është propozimi i Komisionit FunkSIONAL dhe i Bekim Haxhiut.

Ne fillimisht po e hedhim në votim atë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush e mbështet amendamentin 25 të Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 deputetë, e mbështetën, kalon amendamenti 25, versioni i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 26 është i propozuar nga Bekim Haxhiu.

Kush e mbështet amendamentin 26 të Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

59 deputetë ishin kundër amendamentit të Bekim Haxhiu. Asnjë votë për nuk e mori, dy deputetë abstenuan, kështu që nuk miratohet amendamenti 26.

Tash i kemi amendamentet 27, 28, 29, 30 dhe 31, sipas raportit plotësues deri në 31 i kemi. Pra, prej amendamentit 27 deri në amendamentin 31, të gjitha janë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për këto amendamente?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët, miratohen amendamentet 27 - 31.

32-shi i ka dy propozime: atë të Komisionit FunkSIONAL dhe të Bekim Haxhiut. Ne e hedhim në votim versionin e Komisionit FunkSIONAL.

32-shi, Komisioni FunkSIONAL.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, kalon amendamenti i 32-të, propozimi i Komisionit FunkSIONAL

Amendamentet 33, 34, deri në 39. Domethënë, ju kërkoj që të koncentrohemi, sepse i kemi amendamentet 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39, të gjitha janë të Komisionit FunkSIONAL.

Kush i mbështet ato, kush i përkrah?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët votuan. 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Amendamentet 33 – 39 u miratuan.

Tash jemi te amendamenti 40, i cili i ka dy propozime, por një deputet e lëshoi sallën, kështu që i kemi vetëm 60, më duket, a? Presim pak.

Amendamenti 40 i ka dy propozime, atë të Komisionit FunkSIONAL dhe të Bekim Haxhiut, propozimi i dytë. Ne e hedhim në votim atë të Komisionit FunkSIONAL. 61 deputetë të pranishëm.

Kush është për versionin e Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Administrata më thotë që të gjitha votat ishin për, 61 deputetë votuan për amendamentin 40, versioni i Komisionit Funksional, kalon ai.

Edhe amendamenti 41 i ka dy propozime, atë të Komisionit Funksional dhe të Bekim Haxhiut. Ne e hedhim në votim atë të Komisionit Funksional.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë. Kalon versioni i Komisionit Funksional, amendamenti 41.

Amendamenti 42 është i Bekim Haxhiut.

Kush e mbështet amendamentin e Bekim Haxhiut?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

59 vota kundër, 2 vota abstenuese, rrëzohet amendamenti 42.

Amendamenti 43 është i Komisionit Funksional.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjitha votat për, kalon amendamenti 43 me 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Amendamenti 44 i ka dy propozime: ai i Komisionit Funksional dhe i Bekim Haxhiut. Ne e votojmë versionin e Komisionit Funksional.

Kush është për amendamentin 44 të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Kalon amendamenti 44, versioni i Komisionit Funksional.

Tash i hedhim në votim tri amendamentet e fundit, 45, 46 dhe 47, të gjitha janë të Komisionit Funksional.

Kush i mbështet ato?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Të gjitha votat ishin pro, më thonë, 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohen të gjitha këto amendamente.

Tash e hedhim në votim projektligjin së bashku me amendamentet e miratuara.

Kush e mbështet Projektligjin për sportin, bashkë me këto amendamente?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Konstatoj që me 61 vota për, Kuvendi e kaloi Ligjin për sportin.

Tash, të nderuar deputetë, e kemi:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-264 për rininë

Të nderuar deputetë,
Komisioni Funkcional për Arsim e ka shqyrtuar këtë projektligj, na e ka rekomanduar miratimin e tij dhe Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky përmban kosto buxhetore shtesë, por e cila është e përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Amendamentet ndërkaq nuk përmbajnë këso implikimesh.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e tyre.

Po ia jap fjalën kryetarit të komisionit, deputetit Gola, Ardian Gola e paraqet dhe e arsyeton raportin. Urdhëroni, zoti Gola?

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,

Edhe në këtë projektligj kemi punuar fuqishëm, në mënyrë shumë konstruktive dhe pjesëmarrje shumë gjeroze nga të gjithë deputetët e komisionit. U është drejtuar të gjitha komisioneve të përhershme, nuk ka impakt të papërbalueshëm buxhetor, është në përputhje me kornizën e përgjithshme ligjore, nuk shkel të drejtat e komuniteteve dhe është në përputhje me ‘acquis communautaire’

Faleminderit shumë kryetarëve të komisioneve të përhershme për një punë shumë ekspeditive. Kështu që, kërkoj nga deputetët me mirësjellje që ta votojmë edhe këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është projektligji, i ka trembëdhjetë amendamente. Të trembëdhjetat janë të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

I hedhim në votim të gjitha.

Kush është për 13 amendamentet e Projektligjit për rininë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjitha amendamentet me 61 vota miratohen.

Tash po e hedh në votim projektligjin, së bashku me këto amendamentet.

Kush e mbështet Projektligjin për rininë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për rininë.

Për këtë projektligj e kemi një kërkesë nga ana e Komisionit për Ekonomi, ky është:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues

Fjalën po ia japim nënkryetares Statovci, deputetja Jeta Statovci paraqet kërkesën e komisionit.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si Komision për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në bazë të nenit 53 të Rregullores së Kuvendit dhe në kuadër të mbledhjes së mbajtur të këtij komisioni më 9 korrik 2024 është vendosur që Kuvendit t’i paraqitet kërkesa që ky projektligj të tërhiqet nga rendi i ditës, pra pika 12-të, shqyrtimi i dytë i projektligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, për arsye se është

vlerësuar se ka nevojë për konsultime të mëtutjeshme, konform disa komenteve që kemi marrë, edhe nga organizata të ndryshme, edhe nga shoqëria civile. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat kërkesën që t'i kthehet komisionit ky projektligj. Është kërkesë e komisionit, ne e mbështesim atë. E hedhim në votim.

Kush është për këtë kërkesë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

60 vota për, një kundër. Ky projektligj i kthehet komisionit përkatës.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-256 për falimentimin

Jo, kemi amendamente. Në këtë projektligj janë propozuar 42 amendamente, si dhe, sipas raportit të dytë që e patëm këtu me kërkesë të komisionit, plus dy amendamente të tjera shtesë, sipas raportit plotësues.

Të shohim a janë të gjitha të komisionit. Të gjitha këto qenkan të propozuara nga komisioni, kështu që mund t'i hedhim të gjitha në votim.

Përgatituni. A jemi ende... a jo?

42 amendamente, po i hedhim në votim të gjitha, pra, mbasi qenkan kështu.

Të nderuar deputetë, përgatituni për votim. 61 deputetë jemi. 42 amendamente po i hedhim, të gjitha janë të Komisionit FunkSIONAL. Është Projektligji për falimentimin.

Kush i mbështet amendamentet?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohen 42 amendamentet.

Tash po e hedh projektligjin së bashku me këto që i miratuam.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Me 61 votë për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për falimentimin.

E kemi tash:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Ka edhe amendamente të propozuara.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji së bashku me amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e tyre.

Nuk e paskemi kryetarin e komisionit për ta paraqitur, por a e ka marrë dikush këtë detyrë? A do të mund ta bënte këtë eventualisht zoti Dugolli?

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes e ka shqyrtuar në lexim të dytë dhe me vota unanime kemi rekomanduar që kjo pikë e rendit të miratohet dhe ftoj deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: T'i shohim këto amendamente çfarë karakteri kanë. Të gjitha qenkan 17 të propozuara nga komisioni. Ka pasur pajtueshmëri domethënë aty. Të 17-at i hedhim në votim.

Kush i mbështet 17 amendamentet e Projektligjit për mbrojtje nga zjarri?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët, 61, i mbështetën 17 amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

Tash po e hedhim projektligjin, së bashku me këto.

Kush është për Projektligjin për mbrojtje nga zjarri?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për mbrojtje nga zjarri.

Tash e kemi edhe një shqyrtim të dytë:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-267 për letërnjoftimin

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë e ka shqyrtuar projektligjin. Na ka rekomanduar miratimin e tij. Ka edhe amendamente, janë trembëdhjetë me sa po e shoh.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e tyre.

Sërish, dikush duhet në vend të kryetarit Berisha.

Atëherë Dimal Basha. Deputeti Dimal Basha e arsyeton raportin.

DIMAL BASHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Meqenëse kam qenë si udhëheqës i grupit punues, kështu që është bërë një punë e mirë. ministria ka qenë dhe palët e interesit. Kështu që, ftoj deputetët t'i votojnë amendamentet bashkë me projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është prezantimi i raportit. Tash dalim te amendamentet. Trembëdhjetë qenkan. Të gjitha nga komisioni funksional. I votojmë ato njëherësh.

Kush është për?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kalojnë të gjitha amendamentet.

E përsëritim, sepse më thonë që një deputet nuk ka votuar.

Kush voton për trembëdhjetë amendamentet?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Një deputet nuk po voton, kështu që jemi vetëm 60. E shohim se si.

Uluni!

Sa jemi? Vetëm 60 jemi. 61 më duket tash.

61 deputetë.

Janë amendamentet e Projektligjit për letërnjoftimin. Pra, aty mbetëm. Trembëdhjetë qenkan gjithsej. Të gjitha janë nga komisioni funksional. Kështu që, i hedhim të gjitha në votim përnjëherë.

Kush i mbështet këto trembëdhjetë amendamente?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

57 deputetë e mbështetën votimin e amendamenteve, 4 deputetët abstenuan, asnjë votë nuk ishte. Kalojnë këto trembëdhjetë amendamente.

Tash po e votojmë projektligjin në përgjithësi, Projektligjin për letërnjoftimin.

Kush e mbështet projektligjin?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

60 deputetë votuan për, 1 deputet abstenoj, asnjë votë kundër. Kalon Projektligji për letërnjoftimin së bashku me amendamentet.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-274 për shërbimet private të sigurisë

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe na ka rekomanduar ta miratojmë.

Komisioni për Buxhet ka thënë që nuk kemi implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion që janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian se janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve se nuk cenohen as të drejtat, as interesat.

Bëke Berishën sërish nuk e paskemi këtu, po me siguri Dimal Basha ka qenë edhe në grupin punues, e bën paraqitjen e raportit, e arsyeton atë.

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu, pra edhe në këtë projektligj kam qenë kryesues i grupit punues. Për kolegët deputetë, përveç vëmendjes, kërkoj edhe mbështetjen e projektligjit bashkë me amendamente, për shkak se ka pasur një pajtueshmëri mes deputetëve të opozitës po edhe palëve të tjera të interesit që kanë qenë e kanë marrë pjesë në këtë projektligj. Kështu që, ju ftoj që ta votoni dhe ju uroj një mirëseardhje ministrave në këtë seancë.

KRYETARI: Tridhjetë e tre amendamente i paska ky projektligj. Të gjitha të komisionit. Sa jemi? A jemi tash 61?

Kush i mbështet 33 amendamentet e komisionit funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Miratohen të gjitha këto, me 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Tash e hedhim projektligjin në votim.

Është Projektligji për shërbimet private të sigurisë?

Kush e voton projektligjin?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetët, 61 deputetë, 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për shërbimet private të sigurisë.

Të nderuar kolegë,

Tash jemi në pikën e tetëmbëdhjetë:

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Komisioni Funkcional i Legjislacionit ka thënë që ta miratojmë këtë.

Komisioni i Buxhetit që nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë as projektligji as amendamentet.

Komisioni për Integritet Evropian se projektligji është tërësisht në përputhje apo së paku nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve se ky projektligj nuk i cenon dhe nuk i prek interesat e tyre.

Adnan Rrustemi po na propozon ta hedhim drejtpërdrejt në votim.

19 amendamente qenkan. Së pari duhet t'i trajtojmë ato. I kemi të gjitha nga komisioni funksional. Të gjitha janë nga komisioni funksional.

A jemi 61? Përgatituni për votim, të nderuar deputetë!

19 amendamente i paska propozuar komisioni.

Kush i mbështet ato?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë 61 sa janë të pranishëm kanë votuar për këto amendamente. Andaj, unë konstatoj që u miratuan të gjitha, 19 sa ishin.

Tash po e hedh në votim Projektligjin për Këshillin Prokurorial.

Kush e mbështet këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë e mbështetën. Konstatoj që me 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miraton Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Të nderuar kolegë,
Kalojmë te pika e nëntëmbëdhjetë:

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149

Të nderuar deputetë,
Komisioni Funkcional na ka rekomanduar që ta miratojmë këtë projektligj.

Komisioni i Buxhetit na ka treguar që projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Integritet Evropian se projektligji me amendamente nuk bie në kundërshtim me legjislacionin. A ky nuk e ka shqyrtuar fare?

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek interesat e komuniteteve.

Sërish Dimal Basha më duket. A është këtu? Dimal, a na e prezanton raportin me arsyetime?

DIMAL BASHA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po ashtu, kam qenë kryesues edhe në këtë projektligj. Janë bërë disa ndryshime substanciale. Gjithmonë në konsultime me palët e interesit, në veçanti me Odën Noteriale.

Po besoj që kemi arritur t'i bëjmë disa ndryshime të rëndësishme, që do të ndihmojnë në këtë profesion të lirë. Rrjedhimisht bëj ftesë te deputetët që të votojnë amendamentet bashkë me projektligjin.

KRYETARI: E kemi pra Projektligjin për noterinë. Njëmbëdhjetë amendamente i paska propozuar komisioni funksional.

Kush i mbështet?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Të gjithë deputetët po votojnë. Kalojnë këto amendamente me 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

E hedhim edhe projektligjin tash së bashku me amendamentet.

Kush e mbështet Projektligjin për noterinë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 deputetë e mbështetën Projektligjin për noterinë. Prandaj, konstatoj që Kuvendi e miratoi atë.

Tash e kemi pikën:

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Administratën Publike na ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji.

Komisioni për Buxhet ka thënë që ky projektligj nuk ka implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion që amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë pjesërisht në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenon dhe nuk i prekin të drejta dhe interesat e komuniteteve.

Nuk paskam parë ndonjëherë kesi konstatimi që janë pjesërisht. Ka çështje që në mënyrë universale nuk trajtohen nga legjislacioni i BE-së, prandaj shtetet i rregullojnë sipas mënyrës së veçantë të tyre. Kur bie diçka, nuk është pjesërisht, ajo bie në kundërshtim pastaj thuhet në disa pjesë.

Po nuk paskam dëgjuar kështu të ketë.

Kur s'ka, thua kjo çështje nuk trajtohet. Atëherë, e rregullojnë shtetet anëtare në mënyrat e veta.

Këtu po thuhet vetëm janë në pajtim me legjislacionin e BE-së vetëm pjesërisht. Po i bie një pjesë janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Logjikisht nëse e interpretoni.

Nëse janë pjesërisht në kundërshtim, nuk ishte dashur deputetët të votojnë diçka që është në kundërshtim.

93 amendamente qenkan.

A doni fjalën z. Ramadani? Kryetar i Komisionit. Ta arsyetoni raportin. Urdhëro!

VALON RAMADANI: Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

Komisioni Parlamentar për Media ka gjashtë muaj që e shqyrton këtë projektligj. Ka mbajtur tetë dëgjime publike. Një në Kuvendin e Kosovës dhe shtatë në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës.

Kemi pasur komente të shumta si nga organizatat vendore, shoqëria civile dhe OSBE dhe Këshilli i Evropës.

I kemi analizuar të gjitha ato komente me seriozitet dhe në fund ka rezultuar që janë 93 amendamente që e ndryshojnë edhe në përbërje këtë projektligj.

Andaj, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar, shoqëria civile vendore, të gjitha ato organizata vendore e ndërkombëtare. Gjithashtu, deputetë që kanë punuar me seriozitet nga të gjitha partitë.

Në të njëjtën kohë, ju lus që ta votoni edhe ju dhe në të njëjtën kohë t'ju falënderoj edhe ju që e votoni këtë projektligj, si dhe 93 amendamentet që i ka ky shqyrtim. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro! S'i kemi deputetët.

Përgatituni për votim. 93 amendamente të gjitha qenkan prej komisionit funksional.

I hedhim në votim.

Kush i mbështet këto amendamente?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Dimali ka abstenuar. 60 vota për, 1 votë abstenuese. Kalojnë 93 amendamentet e Projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Tash Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

Kush e mbështet këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

59 deputetë e mbështetën projektligjin, 2 deputetë abstenuan, kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin e neve na ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka thënë që nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion që ky është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

Komisioni për Integritet Evropian që këto nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se ky nuk i cenon dhe as nuk i prek të drejtat dhe interesat e tyre.

Kryetari i Komisionit, a është këtu? Z. Ramadani na udhëzon që ta miratojmë atë. Vetëm një amendament nga komisioni funksional.

Kush e mbështet këtë amendament?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë deputetë votuan për, 61. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti i vetëm që e kemi në votim.

Tash, po e hedh projektligjin?

Kush e mbështet projektligjin?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë e votojnë projektligjin. Konstatohet që Kuvendi e miratoi projektligjin me 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Pra, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre.

Të nderuar deputetë,

Ju kërkon durim se jemi afër që t'i shqyrtojmë disa prej pikave që na kanë mbetur.

E kemi tash pikën 22:

22. Shqyrtimi i dytë Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e tyre. Ky ka qenë në kundërshtim të komisionit. Zoti Ramadani na lajmëron që lirisht mund të kalojmë te votimi i amendamenteve. Vetëm 2 amendamente qenkan propozuar për këtë projektligj. I hedhim të dyja në votim.

Të nderuar deputetë,

Kush i mbështet këto të dyja amendamente?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Nuk ka votuar një pjesë e deputetëve. Së paku 3. Së paku 3 deputetë fare nuk kanë votuar. S'paska dëgjuar një deputetë! E përsëritim për çdo rast.

Po them që kemi mbetur te amendamentet. Janë këto dy amendamente, janë të Projektligjit për zyrtarët publikë.

Kush i mbështet këto dy amendamente?

Kush është kundër këtyre amendamenteve?

Kush abstenon?

60 deputetë për. 1 deputet nuk voton fare. Dhe, siç duket ky është qëndrim i tij. Prandaj, nuk kemi çka e përsërisim votimin.

Jo, jo. Ju lutem, 61 deputetë jemi dhe 1 nuk po voton. Sa të doni përsëriteni. S'ka lidhje ajo. Nuk ka mundësi kjo. Sikur të ishim 62, do të ishte tjetër. Atëherë, e bartim këtë projektligj te një seancë tjetër kurdo që mbahet ajo. Një deputet nuk po voton. Jemi 61, shumë e thjeshtë. Nuk ka mundësi që të trajtohet ky projektligj, këto amendamente të Projektligjit për zyrtarët publikë. Mbesin për një seancë tjetër kurdo që e caktojmë atë.

Të nderuar deputetë, tash e kemi:

23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-304 për bankat

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur. Na e ka rekomanduar miratimin e tij. Pikërisht për këtë arsye ka ardhur këtu në seancë ministri i Financave, Hekuran Murati e paraqet edhe e arsyeton këtë projektligj. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që sot para jush të prezantojë Projektligjin për bankat. Ky projektligj ka për qëllim që të rregullojë aktivitetin bankar dhe financiar të bankave në Republikën e Kosovës në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar.

Projektligji do të zbatohet për të gjitha bankat, përfshirë degët dhe bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, bordin e drejtorëve, menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre, si dhe zbatohet për aspektet e kontabilitetit dhe sistemit të raportimit financiar të bankave, përfshirë edhe kërkesat e auditimit.

Projektligji synon të harmonizojë edhe kornizën ligjore për bankat në Kosovë me aktet e AKI të Bashkimit Evropian, si dhe janë përcaktuar edhe masat përmirësuese dhe gjobat administrative që lidhen me procesin e rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji parashihet që të shfuqizohet edhe kreu i parë i Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare sa u përket bankave meqë këto parashihet që tani e tutje të rregullohen me ligje të veçanta. Faleminderit për vëmendje dhe do t'ju lusja që përmes votës suaj ta mundësoni votimin në

parim, në mënyrë që të procedojmë tutje, sepse është kriter edhe sa u përket disa kërkesave të tjera në lidhje me anëtarësimin tonë në SEP-a, në Sistemin Evropian të Pagesave. Faleminderit!

KRYETARI: Po ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Buxhet. Deputeti Armend Muja e ka fjalën. Urdhëroni, zoti Muja!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka trajtuar këtë projektligj dhe të njëjtin e ka rekomanduar që të miratohet në parim për arsye se në qëllimin primar harmonizon të gjitha kriteret për licencimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar në Kosovë, me qëllim që ai të harmonizohet me praktikën dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ajo që është e veçantë është edhe aspektet e rimëkëmbjes bankare që ka qenë kërkesë e të gjitha raporteve të progresit. Andaj, ka rekomanduar që i njëjti të miratohet në parim. Kërkojmë nga deputetët që t'i hapin rrugë shqyrtimit të dytë përmes votës së tyre pozitive.

Në ndërkohë edhe në emër të grupit parlamentar, kryetar, e mbështesim këtë projektligj.

KRYETARI: Grupet parlamentare nuk janë paraqitur. Krejt çka na ka mbetur është të shikojmë nëse e kemi kuorumin e plotë. Edhe një çështje teknike e qartësimi ligjor sa i përket konstatimit lidhur me amendamentet e Projektligjit për falimentimin.

Për ta qartësuar, janë miratuar 42 amendamente të Komisionit Funkcional dhe pastaj 2 amendamente shtesë të komisionit sipas raportit plotësues të komisionit. Veç për ta saktësuar, sepse Administrata po më thotë që e kam konstatuar vetëm 42, jo edhe amendamentet...

Pra, me transkript po mendoj që e qartëson edhe ua lehtëson pastaj formulimin edhe ndërtimin e tekstit saktë të ligjit kur të dalë dhe të botohet në Gazetën Zyrtare.

A jemi 61 apo nuk jemi? 60, po thotë, jemi. 61 deputetë janë të pranishëm. Po votojmë për Projektligjin për bankat. Përgatituni për votim.

Kush e mbështet këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të gjithë, 61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për bankat. Kërkohej nga Komisioni Funkcional edhe komisionet përhershme ta trajtojnë projektligjin dhe pastaj sipas afateve na e sjellin në shqyrtim të dytë kur t'i vijë koha.

Të nderuar kolegë, e kemi në shqyrtim të parë një projektligj tjetër, është ai:

24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Fjalën po ia jap menjëherë ministrit Liburn Aliu, i cili ka ardhur në seancë pikërisht për ta paraqitur dhe arsyetuar projektligjin.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Nënkryetare,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës ligjore në përputhshmëri në legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës, e veçanërisht në fushën e navigacionit ajror, para nesh kemi Projektligjin për ofruesit e shërbimit të navigimit ajror.

Qëllimi këtij projektligji është që të rregullojë statusin, mënyrën e organizimit, kompetencat e ofruesit për shërbimet e navigacionit ajror si subjekt i pavarur juridik në shërbim të interesit publik për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Gjatë përgatitjes së këtij projektligji janë marrë në konsideratë rekomandimet dhe sugjerimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Ky projektligj është hartuar në bazë të rregullave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës dhe janë marrë për bazë të gjitha rregulloret dhe direktivat e Bashkimit Evropian që ndërlidhen me shërbimet e navigacionit ajror të transpozuar përmes akteve nënligjore nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, siç obligon marrëveshja shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit.

Ky projektligj synon sigurimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, ose hapësirës tjetër ajrore për të cilën Republika e Kosovës ka përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të kontrollit të navigacionit ajror për çdo fluturim dhe aktivitet që qarkullon në territorin e Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj do të definohen në mënyrë të qartë përgjegjësitë e institucioneve për zbatimin e tij dhe hartimi i tij me propozimet për zbatim dhe letra e tij rezulton në plotësim të prioriteteve të Qeverisë për sundim të ligjit. Miratimi i këtij projektligji është shumë i nevojshëm. Ju ftoj që ta miratojmë.

KRYETARI: Nëse nuk janë lajmëruar grupet parlamentare, konstatoj që mund të kalojmë drejtpërdrejt... Komisioni a po e merr fjalën? Po, lirisht! Kryetarja e komisionit, Fitore Pacolli urdhëroni!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, në bazë të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen që e kemi mbajtur më 28. 5. 2024 e kemi shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 8/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim në votim. Është Projektligji për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror. A jemi 61? E hedhim në votim këtë projektligj.

Kush e mbështet projektligjin?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 deputetë e votuan projektligjin, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që u miratua në parim Projektligji për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror. Kërkojmë nga Komisioni Funkcional edhe ato të përhershme ta shqyrtojnë dhe pastaj të na e sjellin raportin së bashku me rekomandime sipas afatit që e parasheh Rregullorja.

Tash jemi në pikën 25, por nuk kemi mundësi të procedojmë, sepse Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes më tregon që nuk janë të interesuar të propozojnë kështu. Pastaj për këto pikat e tjera na duhen propozuesit e këtyre rezolutave, të cilët po mungojnë. Janë kryesisht nga opozita.

Kështu që, konstatoj që duhet ta mbyllim seancën në këtë pikë. Mirupafshim, unë gjithnjë them në seancën e ardhshme! Nuk mund t'ju kallëzoj me datë saktë. E mësoni pak më vonë! Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*